



STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

RAPORTI VJETOR

2022



www.spak.gov.al

Rruga
"Jordan Misja"
Nr. 1, Tiranë

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
1. Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftë Kundër Kriminalitetit	6
1.1 Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë	6
1.2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftën Kundër Korrupsionit dhe Kriminalitetit.....	14
2.Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në hetim.....	18
3.Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në gjykim.....	22
4.Veprat penale që lidhen me zgjedhjet për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022.....	24
5.Ekzekutimi i vendimeve penale	25
Kërkesat e paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë për vendosjen në regjim të posaçëm dhe vendimmarrja përkatëse e Ministrit të Drejtësisë.....	26
Praktika administrative të ndryshme të zgjidhura gjatë vitit 2022.	26
6. Përgjimi i komunikimeve elektronike në kuadër të hetimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022	27
Bërthama Komanduese Elektronike	28
7.Sektorit i Ekspertizës në Prokurorinë e Posaçme.....	30
8.Aktiviteti administrativ i Prokurorisë së Posaçme për trajtimin e ankesave të paraqitura	31
9.Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta	31
Kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vendit	32
Skuadrat e përbashkëta hetimore	34
Urdhërat për shpalljen në kërkim ndërkombëtar	35
Ekstradimet	35
Projektet Ndërkombëtare	36
Vizita studimore/trajnime/konferenca jashtë shtetit	38
Marrëveshjet e bashkëpunimit, memorandum me agjencitë vendase dhe të huaja	39
Grupe pune.....	39
Problematika	40
10.Aktiviteti i Koordinatorit për Mediat në SPAK	41
11.Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 202	43
12.Aktiviteti i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.....	44
Konfigurimi i infrastrukturës fizike dhe logjike të pajisjeve Qendrore të Data Center.	44
Financimet nga partnerët ndërkombëtarë	46
13.Plotësimi me personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme	46
14.Analizë e të dhënave buxhetore të SPAK për vitin 2022.....	47

Analiza e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë për vitin 2022 paraqitet.....	51
Shpenzimet e personelit.....	51
Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera	52
Transferta për buxhete familjare	53
Shpenzime për Investime Kapitale.....	53
Ndihma e Huaj	54
Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025	54
TABELA 1	57
TABELA 2	58
TABELA 3	64
TABELA 4.....	66
TABELA 5	73
TABELA 6	75
TABELA 7.....	77
TABELA 9.....	83
TABELA 10	85

Hyrje

Mbështetur në nenin 148/dh të Kushtetutës, Prokuroria e Posaçme është organ kushtetues i pavarur i cili ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë për veprat penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria e Posaçme së bashku me strukturën e specializuar të Policisë Gjyqësore të saj (Byroja Kombëtare e Hetimit) formojnë Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të titulluar (“SPAK”).

Bazuar në përcaktimet e nenit 15/2 germa d) të Ligjit 95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin Dhe Krimin e Organizuar” dhe neneve 104 dhe 105 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokuroria e Posaçme ka përgatitur “Raportin mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2022”. Në Raport paraqiten treguesit e punës, gjendja e kriminalitetit sipas juridiksionit përkatës, efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe ecuria e veprimtarisë së këtij institucioni. Raporti i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Gjithashtu nga SPAK janë mbajtur parasysh Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, si dhe prioritetet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Gjatë hetimit të grupeve kriminale në vitin 2022 vihet re një rritje e sofistikimit të kryerjes së veprave penale nga ana e tyre, komunikimi midis anëtarëve të organizatës, lidhjet me organizatat ndërkombëtare kriminale dhe format e pastrimit të produkteve penale.

Tashmë grupet e strukturuara kriminale të drejtuara nga shtetas shqiptarë po konsiderohen nga agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare si grupe kriminale më një ndikim të rëndësishëm në tregjet ndërkombëtare të drogës, kryesisht në ato të kanabisit dhe kokainës. Këto grupe kriminale janë aktive jo vetëm në rajon por edhe në disa vende të BE-së, Britaninë e Madhe, Turqi, ShBA etj. Nga ana tjetër, grupet kriminale të drejtuar nga shtetas shqiptarë kanë arritur të kenë qasje të drejtë për drejtë në vendet e origjinës së prodhimit të kokainës duke krijuar lidhje të forta me organizatat kriminale në Amerikën Latine. Shihet një tendencë e lëvizjes së të ardhurave kriminale të tyre jashtë juridiksionit shqiptar në kompanitë *offshore* apo në parajsat fiskale duke e rritur ndjeshëm vështirësinë e gjurmimit dhe ndjekjes së tyre penale. Vihet re edhe përdorimi prej tyre i sisteme informale transfertash parash si *havala*, *hundi* apo *‘fei chien’* ose dërgimin e pagesave në parajsat fiskale në vende si Qipro, San Marino apo dhe Dubai.

Është kthyer në problematike edhe fakti që në Emiratet e Bashkuara Arabe, përkatësisht në qytetin e Dubait, qëndrojnë një numër i lartë të kërkuarish me masa sigurimi “arrest në burg” për vepra penale në kuadër të krimit të organizuar, për të cilët nuk po jepet ekstradimi nga autoritetet e drejtësisë së Emirateve të Bashkuara Arabe.

Për të ushtruar sa më mirë funksionet e saj ligjore dhe minimizuar vështirësitë që lidhen me hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjatë vitit 2022 Prokuroria e Posaçme ka pasur në fokus rritjen e burimeve njerëzore me ekspertë financiarë,

qasjen proaktive të hetimeve, rritjen e përdorimit të mjete të posaçme të hetimit dhe një vëmendje më të zgjeruar ndaj sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprave penale.

Duhet cilësuar se rezultatet kanë qenë pozitive falë kjo përkushtimit maksimal të prokurorëve, hetuesve të BKH-së dhe stafit administrativ mbështetës në punën e tyre.

Nga pikëpamja organizative, struktura e SPAK ka ardhur drejt konsolidimit, sidoqoftë plotësimi me prokurorë dhe staf të specializuar mbetet ende në proces. Kështu për vitin 2022, numri i prokurorëve të posaçëm nuk ka ndryshuar nga viti 2021. Nga 20 të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (“KLP”), Prokuroria e Posaçme vijon të ketë në përbërje të saj 17 prokurorë. Për të përmirësuar efikasitetin e institucionit tashmë Rregullorja e Funksionimit të Prokurorisë së Posaçme është në procesin përfundimtar të saj.

Për të forcuar kapacitetet e hetimit, përgjatë këtij viti, është punësuar 1 ekspert i teknologjisë dhe informacionit pranë Sektorit të Ekspertizës dhe është drejt fazës përmbyllëse rekrutimi i 8 hetuesve financiarë pranë Sektorit të Hetimit Financiar.

Ndërkohë gjatë vitit 2022, është plotësuar dhe organika prej 60 hetuesish të BKH-së. Ka filluar gjithashtu faza e përcaktimit të rregullave të qarta të cilat do të normojnë procesin e përzgjedhjes së 50 oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore. Për të përmirësuar kapacitetet njerëzore në fushën e hetimit, është draftuar një rregullore mbi vlerësimin periodik të rezultateve të punës dhe integritetit të oficerëve të policisë gjyqësore të BKH-së e cila është në diskutim e sipër nga SPAK.

Nisur nga sofistikimi gjithnjë e më rritje i krimit të organizuar dhe korrupsionit të ‘jakave të bardha’ një vëmendje e veçantë i është dhënë edhe hetimeve të nisura kryesisht. Kështu, nga 18 procedime penale të filluara kryesisht në vitin 2021, ky numër ka shkuar në 28 në vitin 2022, duke pësuar një rritje më të paktën 56%. Në lidhje me hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, në harkun kohor të tre viteve të fundit, Prokuroria e Posaçme ka arritur të regjistrojë hetime për ish-zyrtarë të lartë gjithsej 24 procedime penale me 25 persona në hetim.

Nga ana tjetër numri i procedimeve penale të regjistruara për veprat penale në kuadrin e krimit të organizuar për vitin 2022 është 79, duke pësuar një rritje të konsiderueshme me 139% krahasuar me vitin 2021, ku ky numër ka qenë 33 procedime penale.

Për të rritur efektivitetin e hetimit ka pasur gjithashtu një rritje të përdorimit të metodave speciale të hetimit. Kështu gjatë vitit 2022 janë interceptuar rreth 11% më shumë paisje fundore se në vitin 2021 dhe rreth 59% më shumë se në vitin 2020.

Është për tu cilësuar edhe rritja e operacioneve ndërkombëtare me pjesëmarrjen e shumë shteteve, dhe me shumë të arrestuar. Për tu veçuar është Operacioni i përbashkët në kuadër të Procedimit Penal Nr. 148, i vitit 2020 dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Itali-Greqi në të cilin janë arrestuar 48 subjekte. Gjithashtu është rritur besueshmëria e partnerëve ndërkombëtarë, edhe tek shtete me të cilat bashkëpunim me parë ka qenë kompleks në kuadër të skuadrave të përbashkëta hetimore. Kështu, gjatë vitit 2022, është krijuar skuadra e parë e përbashkët hetimore mes autoriteteve shqiptare, atyre franceze dhe britanike të drejtësisë, respektivisht në kuadër të procedimeve penale të regjistruara pranë SPAK në lidhje me veprat penale e “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale ose

grupi i strukturuar kriminal”; “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, dhe “Rrëmbimi ose Pengmarrja e një Personi”.

Ndërkohë, ka një rritje të hetimeve të shtrira jashtë vendit të cilat janë reflektuar në intensifikimin e bashkëpunimit me autoritetet gjyqësore të huaja. Nga 51 kërkesa për ndihmë juridike për jashtë vendit në vitin 2021, ky numër është rritur në 62 në vitin 2022. Për tu veçuar është rritja e konsiderueshme e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore, e cila është rritur me 22% nga viti 2021.

Është zgjeruar gjithashtu gama e shteteve më të cilat janë mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe efektive si Italia, SHBA, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Turqi, Holandë, Belgjikë, Spanjë, Greqi, Suedi, por dhe Ekuador, Meksikë etj. Bashkëpunimi me agjencitë ligzbatuese ndërkombëtare si Interpol, Eurojust, Europol, etj., vijon të rritet.

Ndërkohë, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e konsideron thelbësore bashkëpunimin me institucionet e tjera ligzbatuese brenda vendit, duke e forcuar atë kryesisht me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Kontrollin e Lartë të Shtetit, dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Numri i konsiderueshëm i procedimeve të mbartura ngelet problematik. Procedimet e mbartura do të duhet të trajtohen sipas prioriteteve të veprave penale me qëllim përfundimin e tyre në kohë. Evadimi i çështjeve të mbartura mbetet një sfidë me të cilën duhet të përballemi me sukses në vitin 2023. Shqetësuese ngelet edhe mungesa e ekstradimit të eksponentëve të krimin të organizuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe, vend në të cilin kanë gjetur strehë shumë eksponentë të krimin të organizuar. Mungesa e statusit të oficerit të policisë gjyqësore të specialistëve të Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar është gjithashtu një çështje që mbetet për tu adresuar. Një problem tjetër është mungesa e infrastrukturës, faktor i cili vështirëson punësimin e ekspertëve financiar dhe të fushave të tjera për mungesë ambientesh normale pune. Shtimi i një objekti të ri ku do të bëhet një ndarje më e mirë e punës midis Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së është një problematikë që kërkon zgjidhje sa më të shpejtë.

Prioritetet e Prokurorisë së Posaçme për vitin 2023 do të orientohen drejt forcimit të kapaciteteve njerëzore në hetimin financiar dhe pasuror duke përmbyllur kështu procesin e rekrutimit të hetuesve financiar dhe plotësimin me ekspertë të fushave të tjera të Sektorit të Ekspertizës pranë SPAK-ut; do të forcohen më tej kapacitetet teknike duke përmirësuar cilësinë e mjeteve të posaçme të hetimit; do të kushtohet vëmendje procedurave për zgjerimin e infrastrukturës së SPAK-ut; do të ketë një strategji më të qartë në lidhje me ndarjen e çështjeve të mbartura dhe prioritetet e tyre për të rritur eficientë në rastet e hetimeve të tejzgjatura; do të kushtohet rëndësi e veçantë forcimit të hetimeve proaktive; do të ketë një vëmendje të zgjeruar dhe një qasje proaktive edhe në hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve sipas kompetencës lëndore të parashikuar në ligj.

1. Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftë Kundër Kriminalitetit

1.1 Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë

Gjatë vitit 2022 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në funksion të kryerjes me efektivitet të detyrave të saj kushtetuese dhe ligjore ka vlerësuar dhe implementuar rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, të dhëna nëpërmjet “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2021”, të miratuar në seancën plenare të datës 14.07.2022. Në këtë rezolutë, janë adresuar edhe rekomandime për të cilat është kërkuar bashkërendim/bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme:

- 1. Të konsiderojë thelbësore në veprimtarinë e saj pavarësinë institucionale dhe funksionale të strukturës, veçanërisht pavarësinë e prokurorëve në hetim dhe vendimmarrje, si dhe përgjegjshmërinë e llogaridhënien e tyre në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit duke krijuar një sistem të qartë treguesish për punën e çdo prokurori e hetuesi si bazë edhe për vlerësimin e promovimin e tyre individual mbështetur në rezultatet konkrete të punës.**

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Prokuroria e Posaçme, vijon të konsiderojë thelbësore pavarësinë e saj institucionale, në përputhje të funksioneve të saj kushtetuese, duke vijuar gjithashtu me përmbushjen e objektivave të saj në pavarësinë e punës së çdo prokurori të posaçëm.
 - Një tregues pozitiv në këtë aspekt janë edhe rekomandimet e Raportit të Misionit të Vlerësimit të Ekspertëve të Komisionit Evropian kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, i vitit 2022, pas takimit të zhvilluar me prokurorët dhe hetuesit pranë SPAK, ku citohet se *“SPAK përfaqëson një zhvillim të mirë institucional për të luftuar korrupsionin e rëndë dhe krimin e organizuar. Ai ilustron se është në gjendje të japë rezultate të mira dhe pavarësia e prokurorëve dhe hetuesve pranë SPAK është e pa cenuar si një tregues rezultati pozitiv”*.
 - Sa i takon një sistemi tregues për punën e prokurorëve, pranë zyrës së Regjistrimit në SPAK, është ndërtuar një regjistër të dhënash në lidhje me procedimet penale, ku regjistrohen të dhëna mbi ecurinë e çështjeve të procedimeve penale, nga regjistrimi i tyre fillestar deri në dërgimin e tyre në gjykatë, çfarë shërben si një *“track record”* dhe treguesi i punës së prokurorëve në ndjekjen e çështjeve penale.
 - Është gjithashtu *“Rregullorja për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit”*.
- 2. Të vlerësojë si prioritet forcimin e cilësisë së hetimeve përmes përdorimit me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, rritjes së numrit të çështjeve të hetimeve kryesisht dhe hetimeve proaktive, përdorimit më efikas dhe në kufijtë e ligjit të udhëzimeve të**

përgjithshme nga ana e drejtuesve të Prokurorisë së Posaçme, rritjen e shpejtësisë në hetime duke rritur numrin e çështjeve që përmbillen në një vit dhe dërguar për gjykim, si dhe marrjen e masave për aksesin e drejtpërdrejtë në të gjitha databazat shtetërore nga struktura e posaçme për të hetuar çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- I është kushtuar një rëndësi e veçantë regjistrimit të procedimeve kryesisht, dhe më konkretisht gjatë vitit 2022, janë regjistruar si çështje kryesisht 28 procedime penale me 34 persona në hetim, çfarë përbën një tregues pozitiv në rritje të numrit të kësaj kategorie hetimesh krahasuar me vitin 2021, ku ishin regjistruar 18 procedime penale me 9 persona në hetim kryesisht.
 - Duhet cilësuar se prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, përveç përgjimeve telefonike, po aplikojnë në masë të konsiderueshme të gjitha metodat e posaçme të hetimit, apo disa here në të njëjtën çështje (vëzhgime, simulime, dorëzim i kontrolluar, letërpososi, agjentë të infiltruar etj..).
 - Është përdorur me efikasitet metoda e hetimeve proaktive në 122 procedime penale ku janë interpretuar 2177 pajisje fundore, ku vërehet rritje pozitive në numrin e procedime të hetuara nëpërmjet kësaj metode hetimore.
 - Gjithashtu, në vitin 2022, pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë çështjet të hetuara për veprën penale të korrupsionit me 69 procedime penale dhe interceptuar 1023 pajisje fundore;
 - Ndërkohë për çështjet penale të hetuara në kuadër të grupit të strukturuar kriminal janë përdorur metoda të posaçme hetimore në 53 procedime penale dhe janë interceptuar 1154 pajisje fundore.
 - Është rritur gjithashtu gama e databasave shtetërore ku SPAK ka akses të drejtpërdrejtë në Sistemin e gjendjes Civile, ASHK, Drejtorinë e Burgjeve, Regjistrin e Llogarive Bankare, SEMD, DPSHTRR, Regjistrin Noterial Shqiptar, Regjistri i Pronave përfitues, sistemet e policisë së shtetit ADAM, E-Gjoha, Raporte-Statistika, TIMS.
- 3. Të forcojë mekanizmat e kërkesës dhe llogaridhënies së brendshme administrative të prokurorëve dhe hetuesve të SPAK-ut për eficientë dhe efikasitetin e punës, pa cenuar pavarësinë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre ligjor duke rivlerësuar metodologjinë e hedhjes së shortit, plotësimin e detyrimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve që janë objekt shqyrtimi i SPAK-ut në përmbushje të rekomandimeve të progresraporteve të KE-së, rezolutave të Kuvendit, si dhe zbatimit të detyrimeve ligjore.**

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Gjatë vitit 2022 me asistencën e ICITAP, Prokuroria e Posaçme, ka qenë në proces krijimi të një sistemi të brendshëm të menaxhimit të çështjeve (*case management system*) i cili mundëson dixhitalizimin e informacionit dhe të dhënave që lidhen me procedimet penale, me qëllim rritjen e efikasitetit të shkëmbimit të informacionit dhe administrimin

e tyre në mënyrë sa më të shpejtë. Ky sistem do të mundësojë edhe analizën e aspekteve administrative të punës dhe efikasitetin e prokurorëve të posaçëm dhe hetuesve të BKH-së në mënyrë sa më objektive.

- Për të rritur ushtrimin e kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve për punën e hetuesëve të BKH-së janë hartuar “*Rregullorja e Brendshme të Byrosë Kombëtare të Hetimit*” dhe “*Rregullorja për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit*”, të cilat janë ende në fazë vlerësimi dhe konsultimi pranë SPAK.
- Nga ana tjetër, asistuar edhe nga ICITAP, SPAK-u ka kryer konfigurimin e Data Center, pajisjeve qendrore si Switches, Routers, Firewalls, Servers, Storage etj, për të rritur procesimin e të dhënave, rritjen sigurisë së informacionit dhe atë kibernetike, si dhe për të ofruar një mjedis të përshtatshëm pune për të gjithë përdoruesit e teknologjisë së informacionit.
- Ky konfigurim ka lehtësuar punën e ndërveprimit të SPAK-ut me institucionet e tjera të cilat kanë detyrimin që të lejojnë aksesin në databazat shtetërore.

4. Të nxisë prokurorët dhe hetuesit e SPAK-ut, sidomos drejtuesit e tyre për të pasur më shumë fokus, përgjegjshmëri dhe hetime kryesisht dhe proaktive në çështjet e korrupsionit në nivelin e zyrtarëve të lartë, me prioritet çështjet me interes të veçantë publik, pavarësisht kohës së kryerjes së tyre dhe personave të përfshirë në to, për të cilat mbetet ende e fortë pritshmëria dhe shpresa e qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë për respektimin e barazisë para ligjit nga institucionet e reja të drejtësisë, dhe veçanërisht nga SPAK-u.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë vitit 2022, janë dhënë 4 vendime dënimi me 4 persona të dënuar për ish zyrtarë të nivelit të lartë.
- Ndërkohë në periudhën 2020- 2022 rezulton se në total nga Prokuroria e Posaçme janë hetuar gjithsej 24 procedime penale me 25 persona në hetim, ndaj ish-zyrtarëve të nivelit të lartë.
- Ndër këto janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim:
 - 8 procedime penale me 8 të pandehur (ish-Gjyqtar)
 - 3 procedime penale me 3 të pandehur (ish-Prokuror)
 - 1 procedim penal me 2 të pandehur (ish-Deputet)
 - 1 procedim penal me 1 të pandehur (ish-zv.Ministër)
 - 1 procedim penal me 1 të pandehur (anëtare KPK)
 - 4 procedime penale me 4 të pandehur (ish-Kryetar Bashkie)
- Këto arritje janë evidentuar pozitivisht edhe në Progres Raportin e vitit 2022 nga Komisioni Evropian i cili evidenton në mënyrë specifike vendimet e rëndësishme përfundimtare të dhëna nga Gjykatat e Posaçme “*për zyrtarë të lartë të shtetit, përfshirë një ish-ministër të Brendshëm dhe një ish-prokuror të përgjithshëm*”.

5. Të vijojë forcimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit

dhe konfiskimit të asetëve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin dhe të zbatohen standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtës për proces të rregullt, parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Prokuroria e Posaçme, në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve kriminale që rezultojnë nga veprat penale, gjatë vitit 2022 ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë një portofol të diversifikuar asetesh, si pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare si dhe portofole kriptovalutash. Më konkretisht:
 - **Në zbatim të Ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009**, janë paraqitur në gjykatë 5 kërkesa për sekuestrimin e pasurive dhe janë dhënë nga gjykata 5 vendime për sekuestrim pasurie duke sekuestruar përkatësisht: 12 pasuri të luajtshme/ 34 pasuri të paluajtshme/13 subjekte tregtare, nga të cilët 11 subjekte tregtare të konfiskuar plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 2 subjekte tregtare.
 - Po kështu, janë paraqitur në gjykatë 10 kërkesa për konfiskimin e pasurive dhe janë dhënë 2 vendime konfiskimi nga gjykata duke konfiskuar përkatësisht: 4 pasuri të luajtshme/13 pasuri të paluajtshme/11 subjekte tregtare, nga të cilët 4 subjekte tregtare të konfiskuar plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 7 subjekte tregtare.
 - **Në zbatim të Aktit Normativ Nr.1, datë 31.01.2020**, janë paraqitur në gjykatë 3 kërkesa për konfiskimin e pasurive dhe janë dhënë nga gjykata 35 vendime, nga të cilat, për 32 vendime është pranuar kërkesa për konfiskim pasurie dhe në 3 raste është vendosur kthimi i pasurisë, duke konfiskuar përkatësisht: 84 pasuri të paluajtshme/34 pasuri të luajtshme/7 subjekte tregtare, nga të cilët 4 subjekte të konfiskuar plotësisht dhe kuotat përkatëse të personave nën hetim për 3 subjektet e tjerë.
 - **Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, gjatë procesit penal**, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, janë marrë 7 vendime për sekuestrim, përkatësisht 5 vendime të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 vendim i marrë nga prokurorët e posaçëm. Në total janë sekuestruar rreth 34 pasuri të paluajtshme/1 pasuri të luajtshme/10 subjekte tregtare të sekuestruara plotësisht/ Llogari bankare me vlerë rreth 3.000.000 €/ Rreth 770 pajisje kompjuterike/3 portofole kriptovalutash.

6. T'i kushtojë një vëmendje të shtuar zbatimit të kërkesave të ligjit në çështjet penale, të cilat transferohen nga Prokuroria e Posaçme në prokuroritë e rretheve gjyqësore për efekt të juridiksionit.

- Në lidhje me këtë rekomandim, nënvizohet se numri i çështjeve që janë transferuar pranë Prokurorisë së Rretheve Gjyqësore është ulur. Kështu gjatë vitit 2022, janë transferuar pranë Prokurorisë së Rretheve Gjyqësore 82 procedime penale me 61 persona në hetim, ndërkohë që në vitin 2021, janë transferuar 107 procedime penale me 40 persona në

hetim. Nga këto çështje, 5 prej tyre janë me masë arrest me burgim; 5 arrest shtëpie, 4 me detyrim paraqitje dhe 47, 'pa masë'.

- 7. Të përmbyllë procesin e plotësimit të vendeve vakante në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe funksionalitetin e saj, si dhe të përmbyllë të gjitha vakancat në strukturën e BKH-së për sa i përket rekrutimit të 60 hetuesve dhe të krijohet struktura e masave për ushtrimin e kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve për punën e hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit.**

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Prokuroria e Posaçme ka vijuar procesin e konsolidimit të burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të SPAK-ut. Sidoqoftë, vlen të nënvizohet se organika mbetet ende e paplotësuar ku ka ende vende vakante për 3 prokurorë të posaçëm dhe 27 punonjës të administratës civile.
- Përgjatë vitit 2022 është përfunduar procesi i rekrutimit të 32 hetuesve të BKH-së, duke finalizuar në këtë mënyrë plotësimin e kësaj strukture me emërimin e 60 hetuesve pranë BKH-së.

- 8. Të zbatohet në kohë detyrimet që rrjedhin nga ligji për funksionimin efikas të sektorëve të dokumentacionit, studimeve, sidomos atyre të ekspertizës së hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë BKH-së, si dhe për sa çmohet e nevojshme, ngritjen e zyrave mbështetëse jashtë Tiranës.**

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Në vijim të konsolidimit të sektorëve pranë Prokurorisë së Posaçme, gjatë vitit 2022 kanë filluar procedurat për rekrutimin e punonjësve, hetuesve financiar pranë Sektorit të Hetimit Financiar, ku për 8 kandidatët të cilët kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes ka vijuar procesi i vetingut sipas procedurave të shpallura në faqen zyrtare të SPAK.
- Pranë sektorit të ekspertizës pranë Prokurorisë së Posaçme, në vitin 2022 është emëruar një ekspert dhe pranë sektorit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është emëruar një nëpunës civil.
- Sa i takon strukturës së BKH-së, në vitin 2022 struktura ngelet e paplotësuar me 2 vende vakante në kabinetin e Drejtorit të BKH-së, 50 vende vakante në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 3 vende vakante në stafin administrativ.

- 9. Të vazhdojë puna për mirëfunksionimin e SPAK-ut për zbatimin e përcaktimeve të shkronjave “dh”, “ë” dhe “f” të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe për bashkëpunimin me ekspertët ndërkombëtarë të drejtësisë penale për ngritjen dhe zhvillimin e BKH-së.**

Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se:

- Janë mbajtur mbledhje me prokurorët e posaçëm në të cilat janë diskutuar çështje me rëndësi për veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme si dhe çështje të tjera që garantojnë mbarëvajtjen e punës normale në këtë prokurori.
- Nga ana e BKH-së janë hartuar projekt – aktet si më poshtë:
 1. “Rregullorja e Brendshme të Byrosë Kombëtare të Hetimit”
 2. “Rregullorja për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit”;
 3. Udhëzimi, në zbatim të nenit 15, germa “ë” të Ligjit nr.95/2016, nuk është hartuar dhe është detyrim i Prokurorisë së Posaçme.

Gjithashtu, BKH ka iniciuar procesin për projekt-vendimin “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për trajtimin e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, projekt-akt i cili është në fazat përfundimtare për miratimit në Këshillin e Ministrave.

10. Të vijojë koordinimin e veprimtarisë ndërinstucionale dhe efektivitetin për hetimet në ndjekjen penale të financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF), si dhe të raportohet në Kuvendin e Shqipërisë çdo 6 muaj për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Sipas vlerësimit të miratuar së fundmi nga i Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (ICRG)- Financial Action Task Forcë (FATF), se në tetor 2022 cilësohet se:
“Institucionet ligjzbatuese dhe prokuroritë (SPAK) kanë rritur numrin e hetimeve për veprën penale të pastrimit të parave (“çështjet e regjistruara”), rastet e veprave penale me juridiksion të huaj..., duke konfirmuar një fokus më të madh në këtë aspekt të pikës së planit të veprimit, [...], SPAK ka demonstruar se rastet për pastrim parash [...], janë gjithnjë e më në rritje [...].”
- Në vijim, përgjatë vitit 2022 janë raportuar në total pranë ICRG, 12 çështje të reja, të regjistruara dhe në hetim nga SPAK që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, ku janë evidentuar çështje me burim kallëzimi nga juridiksione të huaja, ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore dhe shtrirja e bashkëpunimit me autoritet e huaja homologe në fushën e drejtësisë, sipas rekomandime të FATF.
- Ndërkohë në lidhje me konfiskimet (pika IO.8 e Raportit të Planit të Veprimit), Grupi i Punës së ICRG/FATF vlerëson se Shqipëria ka përmirësuar performancën e saj të përgjithshme të rikuperimit të aseteve, duke përfshirë kryerjen e rregullt të hetimeve financiare dhe identifikimin e pronave për sekuestrim, përfshirë edhe ato në rastet komplekse. Nga qershori 2022, Grupi i Punës së ICRG/FATF është shprehur se të gjithë elementët e këtij plani veprimi janë arritur nga Shqipëria dhe për arsyet e mësipërme, arrin në përfundimin se IO.8 është adresuar plotësisht.

11. Të miratojë një plan veprimi të mirëkoordinuar për forcimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese në bashkëpunim me misionet dhe projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Në lidhje me komponentin e trajnimeve, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në programin e trajnimeve të vazhdueshme pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas tematikave të përcaktuara nga to në përputhje me aktivitetin e SPAK-ut.
- Po kështu prokurorët e posaçëm janë trajnuar sipas tematikave specifike nga organizatat e huaja ndërkombëtare, si OPDAT, ICITAP, EU4FOCAL etj., e konkretisht prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë marrë pjesë në **13** trajnime/vizita studimore, në **26** Takime/Konferenca/Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe terrorizmit.
- Gjithashtu është bërë një takim raportues në kuadër të Kapitullin 23, janë mbajtur 2 takime raportuese për Kapitullin 24, në kuadër të Moneyval janë bërë 2 takime si dhe 2 takime për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me autoritetet e huaja.
- Në lidhje me komponentin Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të SPAK-ut referojmë se administrata ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga DSIK dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

12. Të vijojë zhvillimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve, hetuesve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave me agjencitë e zbatimit të ligjit.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Përveç aktiviteteve të nënvizuara në rekomandimin 11 më lart, SPAK-u është asistuar nëpërmjet Programit ICITAP. Përfaqësues të këtij programi, të cilët janë atashuar fizikisht pranë Prokurorisë së Posaçme kanë vazhduar këtë mbështetje gjatë gjithë vitit 2022, duke u përqendruar në : (a) Trajnimin për grupin e parë të hetuesve të BKH-së, i zhvilluar në SHBA; (b) përfundimin e procesit të përzgjedhjes dhe rekrutimit të grupit të dytë të hetuesve të BKH-së; dhe (d) caktimin e një ish Agjenti Special Mbikëqyrës, si këshillues dhe këshilltar për Drejtorin e BKH-së dhe hetuesit e BKH-së.
- Po kështu, përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, 60 hetuesit e BKH-së kanë marrë pjesë në 36 trajnime brenda dhe jashtë vendit, organizuar kryesisht nga ICITAP, OPDAT, FBI, ILEA- Budapest, CEPOL, EUROPOL, EU4FOCAL, etj.
- Duhet cilësuar se në këto trajnime kanë dhënë kontributin e tyre edhe disa nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, sipas temave respektive gjatë periudhës maj-qershor 2022, **FAZA III – Trajnimi i BKH-së.**

13. Të realizojë marrëveshjet teknike të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, krimin e organizuar, si dhe luftën kundër terrorizmit.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Prokuroria e Posaçme, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, ka nënshkruar marrëveshje të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje. Konkretisht:
 - Në datën 04.02.2022, është nënshkruar Protokoll i Bashkëpunimit Ndërmjet Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion të Rumanisë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të Shqipërisë;
 - Në datën 14.11.2022, është nënshkruar, Memorandum i Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorisë për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit të Rumanisë.
 - Në datën 31.03.2022, në vijim të përmbushjes edhe të rekomandimeve të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) por edhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit, ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

14. Të publikojë udhëzimet e përgjithshme në faqen zyrtare të institucionit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 5, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

- Në lidhje me këtë rekomandim, faqja zyrtare e SPAK, është e konfiguruar në mënyrë të tillë që ti përshtatet kërkesave ligjore të nenit 46, pika 5, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, për publikimin e legjislacionit përkatës dhe akteve për funksionimin e organizimin e Prokurorisë së Posaçme.

15. Të marrë masa për rritjen e transparencës publike përmes një strategjie komunikimi aktive me publikun, informimin e qytetarëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Në lidhje me këtë rekomandim nënvizohet se:

- Prokuroria e Posaçme ka publikuar në faqen zyrtare “Përmbledhjen Mujore” me tregues të punës dhe statistikat mujore të saj. Përmbledhja e muajit publikohet në web në çdo fillim muaji.
- Rubrika e “Njoftimeve” për shtyp në faqen zyrtare të webit përditësohet në kohë reale në lidhje me njoftimet e veprimtarisë së SPAK-ut por dhe çështjeve me ndjeshmëri të lartë për publikun.

- Për të lehtësuar komunikimin me publikun, krahas faqes zyrtare (webit) on-line është aktivizuar edhe llogaria në “twitter” e institucionit.
- Janë zhvilluar gjithashtu një sërë konferencash për shtyp mbi forcimin dhe bashkëpunimin e suksesshëm me partnerët apo homologë ndërkombëtarë lidhur me hetime të suksesshme të përbashkëta.
- Është publikuar gjithashtu në faqen zyrtare të institucionit ‘Programi i Transparencës’. Bashkëlidhur me të gjenden gjithashtu ‘Modeli i kërkesës’ dhe i ankesës, i formateve për kërkim të informacionit/ dokumentacionit”.
- Gjatë vitit 2022, numri i kërkesave të ardhura nga publiku ka qenë i lartë me rreth 162 të tilla, për të cilat është bërë përpjekje për adresuar në kohë informacionin e kërkuar.

16. Të vijojë përpjekjet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit me Bashkimin Evropian referuar rekomandimeve të lëna në progresraportin e datës 19.10.2021, përfshi edhe marrjen e masave për krijimin e “track rekordit” solid për procedimet penale të korrupsionit në nivele të larta, kusht i vendosur edhe nga Komisioni Evropian.

- Në lidhje me këtë rekomandim, siç u përmend edhe në rekomandimin 3 më lart, Prokuroria e Posaçme po krijon një sistem të brendshëm të menaxhimit të çështjeve (*case management system*) i cili mundëson digjitalizimin e informacionit dhe të dhënave që lidhen me procedimet penale, me qëllim rritjen e efikasitetit të shkëmbimit të informacionit dhe menaxhimit të tyre në mënyrë sa më të shpejtë, sistem i cili parashikon edhe “track rekordin” për procedimet penale.

1.2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftën Kundër Korrupsionit dhe Kriminalitetit

1. Në lidhje me rekomandimin “*Forcimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të hetimeve për këto grup veprash penale, numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave;*
 - Prokuroria e Posaçme nënvizon se, gjatë vitit 2022, i është dhënë një vëmendje e zgjeruar hetimit të veprave penale që lidhen me korrupsionin e zyrtarëve të lartë duke u fokusuar kryesisht në çështje komplekse të keqpërdorimit të fondeve publike dhe për të cilat ka pasur një ndjeshmëri të lartë publike. Për këtë arsye numri e kësaj kategorie çështjesh të regjistruar ka qenë më i lartë se ai i regjistruar për veprat penale por dhe personat nën hetim ka qenë më i lartë se ai për veprat penale që lidhen me krimin e organizuar.
 - Duhet cilësuar edhe gjetja e Progres Raportit të vitit 2022 nga Komisioni Evropian i cili nënvizon se “*Progres i mirë është arritur në sekuestrimin dhe konfiskimin e*

aseteve të lidhura me krimin e organizuar. Kjo përpjekje duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.”

2. **Në lidhje me rekomandimin “*Vijimin e rritjes së numrit të hetimeve proaktive (çështje të filluara kryesisht) si dhe përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit, me qëllim vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar referuar kompetencës lëndore*”.**
 - Prokuroria e Posaçme nënvizon se i është kushtuar një rëndësi e veçantë regjistrimit të hetimeve të filluara kryesisht, dhe më konkretisht gjatë vitit 2022, janë regjistruar 28 procedime penale me 34 persona në hetim, çfarë përbën një tregues pozitiv në rritje të numrit të hetimeve kryesisht krahasuar me vitin 2021, ku ishin regjistruar kryesisht 18 procedime penale me 9 persona në hetim.
 - Është përdorur me efikasitet metoda e hetimeve proaktive në 122 procedime penale dhe në 2177 pajisje fundore, ku vërehet rritje pozitive në numrin e procedime të hetuara nëpërmjet kësaj metode.
 - Gjithashtu, në vitin 2022, pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë çështjet të hetuara për veprën penale të korrupsionit (nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, 328) me 69 procedime penale/1023 pajisje fundore; më pas janë çështjet penale të hetuara për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike (283/a/2, 333/a, 334) me 53 procedime penale/1154 pajisje fundore. Nga viti 2022 ka një rritje me 227 pajisje fundore të përgjuara më shumë se në vitin paraardhës.

3. **Në lidhje me rekomandimin “*Rritjen e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimin e asetëve të sekuestruara/konfiskuara*”.**
 - Siç u përmend dhe më sipër, Prokuroria e Posaçme nënvizon se gama e produkteve të veprave penale të hetuara në kuadrin e pastrimit të parave ka qenë e larmishme duke përfshirë këtu për herë të parë edhe hetime që lidhen me kriptovalutat dhe sasi të konsiderueshme parash të depozituara në llogari bankare.

4. **Në lidhje me rekomandimin “*Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale të prokurorëve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe rritjen e numrit të trajnimeve për oficerët e policisë gjyqësore*”.**
 - SPAK ka vijuar rritjen e kapaciteteve profesionale duke u asistur nga projekte të ndryshme ndërkombëtare. Hetuesit e BKH-së kanë marrë pjesë në rreth 36 trajnime brenda dhe jashtë vendit, 13 vizita studimore dhe 26 Takime/Konferenca/Forume të organizuar kryesisht nga ICITAP, OPDAT, FBI, ILEA- Budapest, CEPOL, EUROPOL, EU4FOCAL.

5. **Në lidhje me rekomandimin “*Vijimin e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme*”.**

për sa i përket hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në nivele të larta të politikës dhe administratës publike”.

- Prokuroria e Posaçme ka vijuar të ketë një vëmendje të zgjeruar ndaj hetimit financiar dhe pasuror, ndaj kësaj kategorie veprash penale dhe si rezultat i tyre ka pasur sukses në kërkesat dhe vendimet për sekuestrime dhe konfiskime për të cilat janë evidentuar të dhënat respektive më lart.

6. Në lidhje me rekomandimin “Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikeve, trafiqeve dhe terrorizmit”.

- SPAK i ka kushtuar një vëmendje të veçantë veprave penale në fushën e narkotikëve, trafiqeve dhe sidomos atyre në kuadrin e terrorizmit. Kështu, gjatë vitit 2022 janë mbartur dhe regjistruar 24 procedime penale me 8 persona në hetim për veprat penale me qëllime terroriste dhe janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 3 procedime penale me 3 persona të pandehur, akuzuar për veprat penale me qëllime terroriste, i cili është një tregues pozitiv në krahasim me vitin 2021 ku janë regjistruar 20 procedime penale por nuk ka pasur kërkesa për gjykim.
- Në dhjetor, Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dënoi një shtetas iranian me 10 vite burgim për ofrimin e shërbimeve për organizatat e shpallura terroriste dhe për pjesëmarrje në një organizatë terroriste.

7. Në lidhje me rekomandimin “ Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektivit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

- Në kuadër të ndërveprueshmërisë së sistemeve të informacionit - është nënshkruar Marrëveshja Trepalëshe për dhënien e të drejtës së qasjes në sistemin elektronik “SIENA - Aplikim i Sigurt i Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit”, “EUROPOL”, midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në kuadër të kësaj Marrëveshje tripalëshe, SPAK i shtohet listës së autoriteteve kompetente kombëtare që janë përgjegjës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat kanë qasje të drejtpërdrejtë në sistemin SIENA të Europol. Në këtë kuadër Projekti **IPA 2019/Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor**” gjatë vitit 2022, mbështeti strukturat e SPAK, me pajisje, trajnime dhe ekspertizë të nevojshme për të krijuar qasjen e drejtpërdrejtë në kanalën e SIENA-s të Europol.

8. Në lidhje me rekomandimin “Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave/luftimin e financimit të

terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore”.

- Ka një përmirësim të dukshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadrin e Eurojust, ku mund të nënvizohet se Shqipëria nëpërmjet SPAK ka treguesit më të lartë në rajon në lidhje me formimin e skuadrave të përbashkëta hetimore. Shqipëria kryeson në rajon gjithashtu edhe në mbledhjet e organizuara në kuadër të Qendrave të Përbashkëta të Koordinimit me 4 të tilla, aktivitete të cilat më pas reflektohen në veprimtari të organizuara në kuadër të skuadrave të përbashkëta hetimore ku bën pjesë dhe SPAK. Ndër vendet jo anëtare të BE-së, Shqipëria zë vendin e dytë me 36 mbledhje koordinuese, nga ku SPAK ka marre pjesë në 30 prej tyre. Nga ana tjetër, ndër autoritetet shqiptare të cilat kanë kërkuar asistencë nga Eurojust, SPAK zë vendin e dytë me 8 kërkesa përgjatë vitit 2022.
- Siç edhe u nënvizua më lart, puna e SPAK-ut është vlerësuar me nota mjaft pozitive në luftën kundër pastrimit të parave nga Grupit i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG)- Financial Action Task Forcë (FATF) në tetor 2022.

9. Në lidhje me rekomandimin “Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave për të siguruar një bazë të besueshme për reforma të mëtejshme për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave”.

- Prokuroria e Posaçme ka një praktikë të regjistrimit të të dhënave sipas regjistrave përkatës në mënyre manuale. Por digjitalizimi imenaxhimit të dosjeve konsiderohet shumë i rëndësishëm për përmirësimin e performancës së funksionimit të këtij institucioni. Për këtë qëllim, siç u përmend dhe më lart, së bashku me mbështetjen e ICITAP po vijon puna për krijimin e një sistemi të brendshëm të menaxhimit të çështjeve (*case management system*) i cili parashikon edhe “*track rekord*” për procedimet penale.

2. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në hetim

Në Prokurorinë e Posaçme për periudhën e vitit 2022 **janë hetuar gjithsej 712 proçedime penale**, nga të cilat 455 proçedime penale janë mbartur nga viti 2021, ndërsa 257 proçedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2022 si proçedime penale të reja.

Nga numri total i proçedimeve penale të hetuara, për 69 proçedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke pasur në hetim për këtë periudhë kohore gjithsej 643 proçedime penale me 602 persona nën hetim.

Nga 257 proçedime penale të regjistruara për vitin 2022, 61 proçedime penale kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, 28 proçedime janë të regjistruara kryesisht duke pasur kështu një rritje me 10 proçedime nga viti i mëparshëm. Ndërkohë, janë filluar mbi bazën e referimeve penale të shërbimeve të policisë gjyqësore, të kallëzimeve penale të institucioneve të ndryshme vendase dhe autoriteteve të huaja, enteve private si dhe të shtetasve rreth 168 proçedime penale.

Nga 28 proçedime penale të regjistruara kryesisht me 34 persona në hetim, 3 proçedime janë bashkuar me proçedimet e tjera.


Është vendosur mospranimi i akteve për 19 proçedime penale të dërguara për kompetencë lëndore nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, të cilat janë ridërguar në prokuroritë kompetente.

Nga ana tjetër, në vitin 2022 janë regjistruar gjithsej 177 kallëzime/referime penale nga të cilat **për 60 kallëzime/referime penale** është vendosur **mosfillimi i proçedimit penal dhe për 117 kallëzime/referime penale** është vendosur të regjistrohen si proçedime penale.

Në lidhje me vendimet e mosfillimit të proçedimit penal është paraqitur ankimi në Gjykatë në 37 raste, nga të cilat për 29 vendime është vendosur lënia në fuqi, 1 vendim mosfillimi është shfuqizuar, për 2 vendime mosfillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, si dhe për 5 vendime mosfillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Nga 643 proçedime penale në hetim me 602 persona nën hetim, rezulton se gjatë vitit 2022 kanë përfunduar hetimet për 196 proçedime penale me 436 persona nën hetim/të pandehur, ku për 57 proçedime penale është paraqitur kërkesë për gjykim, për 38 proçedime penale është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes, 82 proçedime penale janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe për 19 proçedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve. Ndërsa, 447 proçedime penale në hetim janë mbartur për vitin 2023

(Tabela 2) .




Në lidhje me **kërkesat për gjykim**, në total Prokuroria e Posaçme ka pasur një rritje të proçedimeve penale të dërguara për gjykim, nga 48 proçedime me 239 të pandehur në vitin 2021 në 57 proçedimet penale me 344 të pandehur në vitin 2022, duke pasur një rritje prej për numër çështjesh me rreth 19% dhe për numër të të pandehurve ky tregues rritet me rreth 44%.

Është e rëndësishme të cilësohet se për vitin 2022 janë dërguar për gjykim 10 çështje penale me 100 të pandehur për vepra penale në kuadrin e krimit të organizuar ku ka një rritje me 16% të numrit të të pandehurve me vitin paraardhës.

Ndërkohë, vlen të nënvizohet se janë dërguar për gjykim 43 çështje penale me 208 të pandehur të akuzuar për vepra penale që lidhen me korrupsionin ku ka një rritje prej 30% të numrit të çështjeve dhe 117% të të pandehurve në krahasim më vitin paraardhës.

Nga ana tjetër, për vepra penale të tjera janë dërguar për gjykim 4 çështje penale me 36 të pandehur gjithsej, ku krahasuar më vitin paraardhës ka një rritje prej 3 çështjesh më shumë. (Tabela 5).



Në 38 proçedimet penale për të cilët është paraqitur **kërkesë për pushimin** e çështjes kanë qenë nën hetim 31 persona, 4 kërkesa për pushim me 13 persona nën hetim për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, 30 kërkesa për pushim me 15 persona nën hetim për vepra penale të lidhen me korrupsionin, 4 kërkesa për pushim me 3 persona nën hetim për vepra penale të tjera (Tabela 3).

Në 82 **proçedimet penale që janë transferuar** në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë qenë 61 persona nën hetim, 11 proçedime penale me 5 persona nën hetim për vepra në fushën e krimit të organizuar, për 59 proçedime penale me 42 persona nën hetim për vepra në fushën e korrupsionit, për 12 proçedime penale me 14 persona nën hetim për vepra penale të tjera (Tabela 6).


Në lidhje me **pezullimin e hetimeve** kemi një rënie të tyre krahasuar me vitin paraardhës. Nga 34 proçedime penale në vitin 2021 për këtë vit ka pasur 19 proçedimet penale. Për hetimet që lidhen me veprat penale në kuadrin e krimit të organizuar nga 22 hetime të pezulluara në vitin 2021 ky numër ka zbritur me 11 raste në vitin 2022. Po kështu, numri i hetimeve të pezulluara për veprat penale që lidhen me korrupsion nga 9 hetime të pezulluara në vitin 2021, ka zbritur në 5 raste për vitin 2022. Numri i hetimeve të pezulluara për proçedime penale që lidhen me vepra penal të tjera, numri prej 3 rastesh ka mbetur i njëjtë (Tabela 7).

Duhet cilësuar sa ka një rritje të **personave nën hetim dhe të atyre për të cilët hetimi ka përfunduar**. Kështu në vitin 2022 ka një rritje prej 16% të numrit të përgjithshëm të personave të hetuar me 602 persona të hetuar krahasuar me 519 një vit më parë (Tabela 4).

Ndërkohë që **për personat që ka përfunduar hetimi** ka një rritje prej rreth 31% ku gjatë vitit 2022 kanë përfunduar hetimet për 436 persona nën hetim/të pandehur nga 332 persona që ishin në vitin paraardhës.

Gjithashtu ka një zbritje të numrit të personave për të cilët **ka një mbartje të hetimit**, nga 187 persona në vitin 2021 me 166 persona në vitin 2022.

Numri i personave për të cilët **kanë përfunduar hetimet**, i korrespondon rreth 72 % e numrit total të personave në hetim (Tabela 8).




Nga numri prej 602 persona nën hetim, 368 prej tyre janë hetuar me **masë sigurimi**, ndërsa 234 persona nën hetim janë hetuar në **gjendje të lirë**.

Nga personat nën hetim të hetuar me **masë sigurimi**, ka një rritje për dhënien e masës së sigurimit “arrest me burg” me 27% nga viti 2021. Kështu nga 218 masa të tilla të dhëna në vitin 2021 në vitin 2022 janë hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, 277 persona, nga të cilat 255 masa janë ekzekutuar, ndërsa për 22 persona është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” në mungesë (Tabela 4).

Masa e sigurimit “arrest në burg” për vepra penale të lidhura me krimin e organizuar ka një rritje me 45%, nga 124 persona në vitin 2021 në 180 në vitin 2022. Gjithashtu, për veprat penale të lidhura me korrupsionin ka një rritje me 63%, ku respektivisht, nga 52 persona në vitin 2021 në 85 persona në vitin 2022. Ndërkohë, gjatë vitit 2022, për vepra penale të tjera kjo masë është dhënë për 12 persona.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është vendosur për 53 persona nën hetim, 32 persona nën hetim janë hetuar me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 1 person për masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, 5 persona me masën e sigurimit “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”.



Në lidhje me çështjet e mbartura ka një përmirësim të lehtë. Për vitin 2023 janë mbartur në hetim 447 proçedime penale nga 449 (2022) me 166 persona nën hetim nga 187 persona (2022).

Nga 447 proçedime penale të mbartura, 131 proçedime penale janë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar me 113 persona nën hetim, nga të cilët 82 prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe 185 proçedime penale me 26 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të korrupsionit. Ndërsa, 31 proçedime penale me 27 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të tjera.

Në grupin e veprave penale të proçedimeve penale të mbartura, numrin më të lartë e mbajnë **veprat penale** të parashikuar në nenin 258 të Kodit Penal (*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve*

në tenderë apo ankande publike), me 73 proçedime penale, që pasohet me 69 proçedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal (*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*).

Nga 166 persona nën hetim në proçedimet penale të mbartura, 88 persona nën hetim janë duke u hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, 9 persona me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 9 persona me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 1 person me masë sigurimi “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, 59 persona në gjendje të lirë pa ndonjë masë sigurim (Tabela 8).

Të dhëna statistikore për veprat penale në fushën e ligjit të dekriminalizimit

Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me date 07.09.2021 ka regjistruar proçedimin penal me Nr.236 për 1 person nën hetim i akuzuar për veprën penale të “*Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve*”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal dhe në datë 01.11.2021. Çështja është dërguar në Gjykatë dhe gjykimi vazhdon në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë.

3. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në gjykim.

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2022 ka një përmirësim të këtij treguesi me 11%, ku prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e 142 çështje penale themeli, me 626 persona të akuzuar nga 128 çështje me 418 të akuzuar në vitin 2021.


Për vitin 2022, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë dhënë gjithsej 70 vendime me 213 persona nga të cilat rezulton se: ka përfunduar gjykimi i themelit për 49 çështje penale me 187 persona. Për 3 çështje penale me 8 persona të pandehur është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe janë dërguar për kompetencë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore.

Përveç çështjeve penale të mësipërme, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë edhe në gjykimin e 18 çështjeve penale me të dëmtuar akuzues, që kanë paraqitur kërkesë drejtpërsëdrejti në gjykatë, me 18 persona të akuzuar, ku numri i këtyre çështjeve ka një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin paraardhës.

Ndërsa, për 72 çështje penale themeli me 413 persona të pandehur vazhdon gjykimi, duke u mbartur për tu gjykuar në vitin 2023.


Prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në **840 seanca gjyqësore** të zhvilluara në këtë shkallë gjykimi nga ku 290 në grup veprat penale në kuadër të krimit të organizuar, 392 për korrupsionin dhe veprat e tjera dhe 158 për çështjet me të dëmtuar akuzues.

Treguesit për numërin e çështjeve penale në gjykim



Në 46 çështjet penale për të cilat **ka përfunduar gjykimi i themelit** në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë dënuar gjithsej 175 persona. Nga këto, 19 çështje penale me 35 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 27 çështje penale me 140 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera (Tabela 9).

Treguesit për personat e dënuar



Pafajësitë. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka dhënë pafajësi të plotë në 3 çështje penale, për 7 persona të akuzuar (vendimi nr.12, datë 14.02.2022, vendimi nr.39, datë 10.06.2022, vendimi nr.48, datë 16.09.2022), si dhe është dhënë pafajësi për 5 të pandehur në një çështje penale me disa persona të akuzuar (vendimi nr.33, datë 23.05.2022, vendimi nr.8, datë 04.02.2022).

Pushimet në gjykim. – Për 6 çështje me 6 persona me të dëmtuar akuzues është vendosur pushimi i çështjes në gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2022, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjeve penale të themelit, si dhe në gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për kërkesat

e prokurorisë gjatë fazës së hetimeve paraprake. Për vitin 2022 në Gjykatën e Apelit ka përfunduar gjykimi për 37 çështje penale themeli, me 127 persona të akuzuar dhe të dënuar. Nga këto çështje penale për të cilat është përfunduar gjykimi në apel, 15 çështje penale me 47 të pandehur janë gjykuar për vepra penale të krimit të organizuar, ndërsa 22 çështje penale me 80 persona të pandehur janë gjykuar për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera (Tabela 10). Prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në **399 seanca gjyqësore** të zhvilluara në këtë shkallë gjykimi.

Pafajësitë. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Vendimin nr. 47, datë 21.10.2022 ka lënë në fuqi dhënien e pafajësisë për 1 çështje penale për 3 persona (vendimi nr.12, datë 14.02.2022 në shkallën e parë të gjykimit). Në lidhje me çështjet e tjera për 9 të akuzuar për të cilat vendosur pafajësi në shkallën e parë të gjykimit, çështjet janë ende në gjykim në këtë Gjykatë.

Në Gjykatën e Lartë gjatë vitit 2022 prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e 8 çështjeve penale, nga ku mund të veçohen **rekurset e fituara** me objekt **1)** caktim mase sigurimi, me Vendim të Kolegjit Penal Nr. 00-2022-1231 datë 11.10.2022 dhe **2)** ankim ndaj vendimit të gjykatës për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimet ndaj prokurorëve dhe gjyqtareve të SPAK-ut me Vendim të Kolegjit Penal Nr. 00 – 2022 - 482 datë 12.04.2022.

Në Gjykatën Kushtetuese gjatë vitit 2022 prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në 3 raste.

4. Veprat penale që lidhen me zgjedhjet për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022

- Numri i materialeve kallëzuese referuese dhe informacioneve të depozituara pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, lidhur me krimet zgjedhore është 152, nga të cilat :

- Për 20 materiale është vendosur mosfillim procedimi.
- Në lidhje me 19 materiale dhe informacione është vendosur dërgimi për verifikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
- Për 50 materiale dhe informacione është vendosur dërgimi për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
- Në lidhje me 63 materiale është vendosur regjistrimi i procedimit penal.

- Janë regjistruar gjithsej 63 procedime penale të lidhura me krimet zgjedhore

- Gjatë vitit 2021-2022 nga regjistrimi gjithsej i 63 procedimeve penale të lidhura me krimet zgjedhore, është marrë vendim për ndarjen e 3 procedimeve penale.

- Gjithsej procedime të hetuara në lidhje me krimet zgjedhore, janë 66 procedime penale, nga të cilat rezulton :

- 5 procedime janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për gjykim me 7 të pandehur, me masë sigurimi 2 persona (arrest në burg) dhe 2 persona (arrest në shtëpi) dhe 1 person (detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore)

- 12 procedime janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim me 4 persona në hetim, me masë sigurimi 2 persona (arrest në shtëpi) dhe 1 person (detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore)
- 25 procedime janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
- 4 procedime janë pezulluar
- 4 procedime janë të bashkuara me procedimet e tjera
- Aktualisht në hetim janë 16 procedime penale.

5. Ekzekutimi i vendimeve penale

Në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është caktuar një specialist për ekzekutimin e vendimeve penale. Specialisti ndihmon prokurorët në nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kryen detyra administrative, si dhe mban të dhëna statistikore në lidhje me ekzekutimet e kryera. Të dhëna statistikore në lidhje me ekzekutimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë gjatë vitit 2022 janë si më poshtë :

- Nga Janari i vitit 2022 deri më 31.12.2022, janë ekzekutuar 55 vendime gjykate të formës së prerë. Nga këto 18 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe 37 vendime kanë marrë formë të prerë në Gjykatën e Posaçme të Apelit.
- Janë dënuar me vendim të formës së prerë **207 të pandehur, nga të cilët:**
 - me burgim janë dënuar 158 persona.
 - me kusht, kohë prove janë dënuar 40 persona.
 - me orë pune janë dënuar 3 persona.
 - me gjobë janë dënuar 4 persona
- Numrin e të pandehurve për të cilët gjykata ka vendosur deklarin e pafajshëm apo pushimin e çështjes. Janë 2 shtetas për të cilët Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur;
 - Për njërin pushimin e gjykimit dhe caktimin e masës mjekësore “mjekim i detyruar ambulator”.
 - Dhe për tjetrin përjashtim nga vuajtja e dënimit penal.
- Gjatë vitit 2022, përveç deklarinimit fajtor dhe masës së dënimit me burg apo me kohë prove, është dhënë dhe dënimi plotësues “**ndalimi për të ushtruar funksion publik**”, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal për **29 persona**.

Konfiskim i pasurisë në proces penal.

Është dhënë konfiskim pasurie në proces penal, në 20 vendime penale.

1. Pasuri të paluajtshme të konfiskuara

- Apartamente 2 (dy).
- Tokë me sipërfaqe 314.951 m²

2. Vlera monetare të konfiskuara në lek, euro dhe dollar.

- 2.507.800 Leke (dy milion e pesëqind e shtatë mijë e tetëqind)
- 52.974 Euro (pesëdhjetë e dymijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër)
- 19.300 USD (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind)
- 1.005 GBP(një mijë e pesë)
- 2.200 Franga (dymijë e dyqind)

3. Pasuri të luajtshme të konfiskuara

- Automjete 18 (tetëmbëdhjetë)
- Aparate celulare 221 (dyqind e njëzetë e një)
- Laptop 6 (gjashtë)
- Pajisje dëgjimi 1 (një)

Kërkesat e paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë për vendosjen në regjim të posaçëm dhe vendimmarrja përkatëse e Ministrit të Drejtësisë.

- Janë paraqitur kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për zgjatjen e afatit të regjimit të posaçëm dhe janë konfirmuar me vendim nga Ministri i Drejtësisë për 4 (katër) të dënuar.
- Janë paraqitur kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për vendosjen në regjim të posaçëm dhe janë konfirmuar me vendim nga Ministri i Drejtësisë, për 3 (tre) persona.
- Janë bërë ankime në gjykatë kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë për vendosje në regjim të posaçëm në 7 (gjashtë) raste, nga të cilat ka përfunduar gjykimi dhe është lënë në fuqi vendimi për 4 (katër) person dhe për 3 (tre) personat e tjerë gjykimi nuk ka përfunduar brenda vitit 2022 dhe vazhdon gjykimi ne Apel .

Praktika administrative të ndryshme të zgjidhura gjatë vitit 2022.

- Janë nxjerrë urdhrat e prokurorit për ekzekutimin e vendimeve penale për **207 të dënuar**, duke krijuar praktikat përkatëse në bashkëpunim me prokurorët e çështjeve.

- Janë përgatitur vendimet për miratimin e takimeve të të paraburgosurve me familjarët e tyre për **210 (dyqind e dhjetë)** raste, sipas kërkesave të të paraburgosurve apo avokatëve të zgjedhur prej tyre.
- Për të paraburgosurit në Regjim të Posaçëm është pranuar kërkesa për lejimin e një bisede telefonike në muaj me familjarët e tyre dhe për takimin e tyre me familjarët dhe përgatitur vendimi i prokurorit **në 96 vendime lejim takimi apo për bisedat telefonike.**
- Gjatë vitit 2022, **janë 40 shtetas që kanë përfunduar vuajtjen e dënimit** dhe është nxjerrë vendimi nga prokurori për përfundimin e këtij dënimi. Vendimi i është dërguar Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin i dënuari, duke vënë në dijeni dhe Gjykatën.
- Janë kthyer përgjigje institucioneve dhe shtetasve të ndryshëm, sipas kërkesave të ardhura në prokurori duke ju dhënë zgjidhje problematikave të paraqitura.
- Janë krijuar dosjet e ekzekutimit të vendimeve penale për çdo të dënuar.
- Është mbajtur regjistri elektronik dhe manual për çdo të dënuar duke shënuar të dhënat kryesore sipas kolonave përkatëse.
- Është mbajtur në mënyrë elektronike Regjistri i Konfiskimeve, sipas vendimeve të gjykatës dhe emrave të të dënuarve, ku përcaktohet qartë konfiskimi i pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe vlerat monetare përkatëse.
- Është mbajtur regjistri elektronik dhe manual për personat e vendosur në regjim të posaçëm.

6. Përgjimi i komunikimeve elektronike në kuadër të hetimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022

Gjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit **për 122 proçedime penale.**

Kjo veprimtari, deri në 27 Qershor 2022, është ndjekur nga 9 (nëntë) Oficerë të Policisë Gjyqësore të Policë së Shtetit (*shkresa Nr. 576 date 23/03/2021 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*) dhe 5 (pesë) hetues të BKH-së (*Urdhër Nr. 32 date 18/01/2022 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme*) të cilët kanë qenë të ndarë në 7 grupe të organizuar me turne.

Me datë 27/06/2022, me ardhjen e grupit të dytë të hetueseve, behet emërimi i 12 hetuesve të ndarë në 6 grupe (*Urdhër i përbashkët Nr. 359, 126 date 16/06/2022 dhe 359/1, 126/1 datë 27/06/2022 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit*). Oficerët e Policisë Gjyqësore të Policë së Shtetit asistuan hetuesit deri në lënien e tyre të lirë me datën 15/07/2022.

Trajnimi i hetuesve të BKH-së (*32 hetues*) për sistemin e përgjimit u bë në ambientet e zyrës së përgjimit, në dy faza në muajt maj-qershor.

Nga data 27/06/2022 e në vazhdim, përgjimi kryhet nga 12 hetuesit e BKH-së (Urdhër i përbashkët Nr. 359, 126 datë 16/06/2022 dhe 359/1, 126/1 date 27/06/2022 i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të BKH-së).

Për periudhën një vjeçare, janë bërë përpjekjet maksimale, duke përballuar me sukses volumin e madh të punës (*krahasuar me vitet e mëparshme*). Tabela përmbledhëse më poshtë.

TOTAL 2022													
Procedimi Penal	Vepra Penale	Nr. All	Te ndaluar	Transkripte	flete	DVD	BD-R	V. Prokurori	V.Gj. Vleftesim	V.Gj.lejimi	V.Gj. Zgjatje	V. Gjykate all	U. nderprerje
122		2177	160	7291	9071	26	8	328	307	160	533	1000	13

Përkushtimi, profesionalizmi, përgjegjësia për të kapur në kohë e vlerësuar drejt të dhënat e përfituara nga interceptimi, në disa raste kanë dhënë rezultate përtej dyshimit që ekzistonte ndaj subjektit të vendosur nën përgjim. Mbi të dhënat e interceptimit jashtë objektit të hetimit, është mundësuar regjistrimi i procedimeve penale më vite.

Duke qenë se natyra e punës në zyrën e përgjimit është dinamike dhe duhet të ndiqet në kohë reale, Oficeret e Policisë së Shtetit dhe Hetuesit e BKH, për situata emergjente dhe operationale, por edhe për shkak të ngarkesës së madhe të punës, kanë qëndruar në punë jashtë orarit, si në ditët zyrtare të punës ashtu dhe në ditët e pushimeve javore, vjetore dhe të festave zyrtare.

Në periudhën që analizojmë nuk ka ndodhur asnjë rast dekonspirimi i të dhënave të përfituara nga interceptimi. Oficerët e policisë gjyqësore/Hetuesit e BKH-së të Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike, krahas detyrimit për kalimin e informacionit në kohë dhe në dinamikë dhe përgatitjen në kohë të transkripteve të shkruara të materialit të përgjuar, garantojnë dërgimin e menjëhershëm të tyre prokurorit që ka kërkuar përgjimin. Numri i personave, të cilët mund të njihen me materialin e përgjuar është i kufizuar. Materiali i përgjuar nuk i vihet në dispozicion asnjë personi, i cili nuk ka kërkesë zyrtare ose nuk është i autorizuar për të marrë këtë informacion.

Reduktimi i hetueseve (nga 7, në 6 grupe), dhe rritja e ngarkesës, ka bërë që në 6-mujorin e dytë ky grup hetuesish të përballet me volumin më të madh të punës krahasuar me vitet e kaluara.

Gjatë vitit 2022, Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit pranë kësaj zyre kanë qenë të përkushtuar në përmbushjen e detyrave funksionale të tyre në procesin e realizimit të procesit të përgjimit dhe të transkriptimit.

Bërthama Komanduese Elektronike

Specialistët e Bërthama Komanduese Elektronike, kanë ushtruar përgjegjësinë që diktohet në rregulloren dhe urdhrat për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në funksion të realizimit të proceseve teknike të

përgjimit të komunikimit elektronik, në bazë të neneve 221- 226 të Kodit të Procedurës Penale, vëmendja është përqendruar në marrjen dhe ekzekutimin në kohë të vendimeve të përgjimit, ruajtjen e sekretit hetimor, administrimin e ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me procesin e përgjimit dhe aktet që e shoqërojnë, trajnimin dhe mbështetjen nga ana teknike të Hetuesve dhe Oficerëve të policisë gjyqësore, mirëmbajtja e sistemit etj. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme, janë mbajtur kontakte dhe komunikime me kompaninë që mbulon mbështetjen (mirëmbajtjen) teknike të sistemit të përgjimit. Gjatë këtij komunikimi, nga ana jonë, në funksion të mirëmbajtjes së sistemit, janë identifikuar një sërë problematikash, ku shumica prej tyre janë zgjidhur në kohë.

Për vitin 2022, Bërthama Komanduese Elektronike, ka ekzekutuar në interes të çështjeve penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si më poshtë:

- **328 Autorizime të Prokurorit** për lejim përgjimi;
- **1000 Vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, nga të cilat
 - **160 Vendime Lejim Përgjimi**
 - **307 Vendime Vleftësimi**
 - **533 Vendime Zgjatjeje**

Gjatë vitit 2022, për veprat penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme, **janë interceptuar 2177 pajisje fundore** (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim) ku është rezultuar në **ndalimin e rreth 160 personave të dyshuar për kryerje të veprave penale**.


Krahasuar me vitin 2021 (grafiku i mëposhtëm) kemi një **rritje të ngarkesës me 220 pajisje fundore**.

Më poshtë gjendet pasqyra më e detajuar e proçedimeve penale sipas veprave penale për vitin 2022 për të cilat është kërkuar përgjimi telefonik.

PASQYRË PËRMBLEDHËSE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2022	2022	2021	2020
<u>PROCEDIME PENALE</u>	122	129	91
<u>PAJISJE FUNDORE</u>	2177	1957	1373
<u>AUTORIZIME PROKURORI</u>	328	411	391
<u>VENDIME GJYKATE</u>	1000	1204	943
* 160 Vendime Lejimi			
* 307 Vendime Vleftësimi			

* 533 Vendime Zgjatje			
<u>PROCESVERBALE TRANSKRIPTIMI...</u>	7291 (9071 flete)	8659	7480

Paraqitja grafike sipas disa zërave krahasuar me vitin 2020, 2021



Në vitin 2022, pjesën më të madhe të proçedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, *e kryesojnë çështjet të hetuara për veprën penale të korrupsionit* (nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, 328) **me 69 proçedime penale/1023 pajisje fundore**; më pas janë *çështjet penale të hetuara për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike* (283/a/2, 333/a, 334) **me 53 proçedime penale/1154 pajisje fundore**.

Nga këto, disa proçedime janë finalizuar me masa të ndryshme sigurimi nga Gjykata për 160 persona, ku me pikantet mund të përmendim:

Procedimi 141 viti 2021, regjistruar për veprat penale 283/a, 333/a, 334 dhe në bashkëpunim me agjenci të huaja ligj zbatuese, është finalizuar me ndalimin e 10 personave dhe u sekuestruan në cilësinë e provës rreth 485 kg kokainë.

Procedimi Nr. 187 viti 2020, regjistruar për veprat penale të "korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", u finalizua me arrestimin e 5 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve shtetëror që kanë mbajtur funksione publike.

7. Sektorit i Ekspertizës në Prokurorinë e Posaçme.

Për vitin, në Sektorin e Ekspertizës janë pranuar 240 vendime ekspertimi për ekzaminimin e provave digjitale në procese hetimi apo gjykimi të ndara si më poshtë:

- Nga 240 vendime janë pranuar 328 aparate celularë, 59 kompjuter dhe laptop, 11 video-regjistruer DVR, 17 USB, 3 borde të intergruara (qark elektronike), 3 TV, 4 GPS (lokalizues vendodhjeje), 4 Dronë, 46 CD/DVD, 11 tableta si dhe 14 pajisje të tjera që përfshijnë karta SIM, adaptorë, magnetofon.
- Në sektorin e ekspertizës, nga 3 ekspertë, për periudhën në fjalë janë kryer 256 Akte Ekspertimi dhe është bërë e mundur ekzaminimi i 313 aparateve celularë, 40 kompjuter dhe laptop, 7 DVR, 23 USB, 1 GPS (lokalizues vendndodhjeje), 1 Dron, 25 CD, 3 tabletë si dhe 10 pajisje të tjera që përfshijnë karta SIM, adaptorë, magnetofon.

Duke u nisur nga numri i vendimeve dhe provave të pranuar dhe nga tendenca rritëse e tyre, nga Sektori i Ekspertizës rekomandohet shtimi dhe zgjerimi i sektorit me ekspert/ë të tjerë.

8. Aktiviteti administrativ i Prokurorisë së Posaçme për trajtimin e ankesave të paraqitura

Drejtuksi i Prokurorisë së Posaçme ka hartuar dhe miratuar 900 urdhra në funksion të ushtrimit të kompetencave që ka sipas ligjit Nr.95/2016.

Janë regjistruar në regjistrin e protokollit për kallëzimet penale 806 materiale kallëzuese/ankesa gjithsej. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka dhënë zgjidhje duke dërguar 327 për moskompetencë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, për vlerësim 24 ankesa në Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, etj., 48 janë dërguar për verifikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, 168 ju është kthyer përgjigje dhe 83 janë arkivuar, 60 kanë vendime mos fillimi procedimi penal si dhe ankesa të përsëritura.

Janë protokolluar gjithsej në Regjistrin e protokollit 11439 shkresa së bashku me praktikat hyrëse dhe dalëse. Janë paraqitur 432 kërkesa të ndryshme nga shtetas, shoqata, gazetarë dhe subjekte të ndryshëm, 711 kërkesa/memo nga avokatë të cilave ju është dhënë zgjidhje ligjore, nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët përkatës. Janë 1168 shkresa korrespondencë me institucione të ndryshme.

Informacion për shkresat e ardhura nga institucione dhe individë të ndryshëm gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022 nga zyra e regjistrit janë verifikuar dhe është kthyer përgjigje për kërkesat për informacion të ardhura nga institucione dhe individë të ndryshëm me objekt “ informacion nëse janë në ndjekje penale.

Pas verifikimeve në lidhje me shkresat e ardhura nga institucione dhe individë të ndryshëm rezulton që janë dërguar gjithsej 702 shkresa për kthim përgjigje.

9. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta

Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta është përgjegjës për koordinimin e punës së saj me autoritetet e shteteve të huaja. Sektori shërben si ndërlidhës me autoritetet e huaja në shërbim të ecurisë së ekzekutimit të kërkesave për ndihmë juridike nga brenda jashtë apo anasjelltas; si ndërlidhës gjatë hetimeve të përbashkëta, ekstradimeve, marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën Qendrore të Interpol-it, Eurojust, Europol, etj.


Kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vendit

Gjatë vitit 2022, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë trajtuar **54** kërkesa për ndihmë të ndërsjelltë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, në bazë të konventave të Këshillit të Evropës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është pjesë.

Nga këto janë ekzekutuar **39** kërkesa dhe **vijon procedura për ekzekutimin për 15 kërkesa. Aktualisht** numri total i kërkesave për vitin 2020 – 2022, për të cilat nga Prokuroria e Posaçme vijon ende procedura për ekzekutimin e tyre është **21**.

Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë lidhur me hetime në kuadër të veprave penale kryesisht në fushën e korrupsionit, trafikimeve të lëndëve narkotike, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, vjedhje, falsifikimit të dokumenteve, etj., vepra këto të kryera në formën e bashkëpunimit të veçantë, grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 244, 283/a, 287, 143, 143/b, 134, 186, 28, 333/a dhe 334 të Kodit Penal. Numri i madh i tyre, tregon për rëndësinë e veçantë që kjo prokurori i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Holanda me numrin më të madh të kërkesave, **11** kërkesa, Belgjika **8** kërkesa, Gjermania dhe Kosova **6** kërkesa, Italia **5** kërkesa, Franca **4** kërkesa, Maqedonia e Veriut **3** kërkesa, Greqia, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia me nga **2** kërkesa dhe të tjerat janë Hungaria, Portugalia dhe Spanja me nga **1** kërkesë.




Kërkesat për ndihmë juridike për jashtë vendit

Krahas kërkesave për ndihmë juridike që lidhen me hetime të autoriteteve të huaja, lidhur me hetimet e Prokurorisë së Posaçme është e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore apo verifikimeve jashtë shtetit shqiptar, kryesisht në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit, shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankandeve publike, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhur vendor, trafikimeve të lëndës narkotike, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, vrasje me paramendim e mbetur ne tentative, vjedhje, falsifikimit të dokumenteve, etj., vepra këto të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 244, 248, 258, 319, 319/a, 319/b, 283/a, 287, 143, 143/b, 78, 134, 186, 28, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

Për kryerjen e këtyre veprimeve në vitin 2022, nga Prokuroria e Posaçme janë përpiluar **62** kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja.

Nga këto janë ekzekutuar **33** kërkesa dhe **vijon procedura për ekzekutimin për 29 kërkesa**. **Aktualisht** numri total i kërkesave për vitin 2020 – 2022, për të cilat nga autoritetet e huaja vijon ende procedura për ekzekutimin e tyre është **48**.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Italia **12** kërkesa, Kosova **7** kërkesa, SHBA dhe Maqedonia e Veriut **6** kërkesa, Gjermania **4** kërkesa, Holanda, Mali i Zi, Belgjika dhe Franca **3** kërkesa, Zvicër, Greqi dhe Britania e Madhe **2** kërkesa, dhe të tjerat nga **1** janë : Ekuadori, Çekia, Suedia, Spanja, Austria, Qipro, San Marino, Meksika dhe Turqia.



Skvadrat e përbashkëta hetimore

Një tjetër fushë e marrëdhënieve me jashtë, është dhe krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore.

Në vitet 2021-2022, janë krijuar 10 Skuadra të Përbashkëta Hetimore aktive, në funksion të hetimeve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet e huaja të drejtësisë gjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë krijuar **10** Skuadra të Përbashkëta Hetimore (të reja). Proçedimet penale për të cilat janë krijuar këto skuadra, kanë objekt hetime në fushën e trafikimit të narkotikëve, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, veprat penale kundër terrorizmit, rendit dhe sigurisë publike, si dhe vepra me qëllime terroriste, financimi i terrorizmit, mashtrimit, mashtrimit kompjuterik, korrupsionit, kontrabandës së barnave, pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, vepra të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal në nenet, 283, 283/a, 230, 230/a, 234, 143, 143/b, 28, 109, 333/a dhe 334.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Italia me numrin më të madh me **6** skuadra të përbashkëta **1** skuadër me Italinë dhe Kosovën, **1** skuadër e përbashkët me palë Suedi-Ukrainë-Spanjë-Gjermani-Gjeorgji-Finlandë-Letoni, **1** skuadër me Francën, **1** skuadër me Britaninë e Madhe.

Në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2022, janë mbajtur takime koordinuese me autoritetet e huaja palë në këto skuadra, ku në vendin tonë janë zhvilluar 8 takime dhe jashtë vendit 17 takime, përveç mbledhjeve të mbajtura nëpërmjet video-konferencës.

Përsa i përket aksioneve/operacioneve të përbashkëta realizuar me partnerët ndërkombëtarë si dhe numrin e personave të arrestuar për vitin 2022, në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore ato janë:

1. Operacioni i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 148, i vitit 2020** dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Itali-Greqi. Në kuadër të këtij operacioni, janë arrestuar 48 persona, 23 në Itali dhe 25 në Shqipëri. Procedimi penal Nr. 148, i vitit 2020, është dërguar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 17.06.2022, me 25 të pandehur të cilëve iu është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”;
2. Operacioni i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr.39 i vitit 2022** dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK - Itali.
3. Operacioni i përbashkët në kuadër të **Procedimeve Penale Nr. 56 dhe Nr. 77 të vitit 2022**, dhe Skuadrës së Përbashkët Hetimore me palë SPAK-Francë.
4. Operacioni i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 166, i vitit 2021** dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore, me palë SPAK - Itali. Në kuadër të këtij operacioni, janë regjistruar 2 persona nën hetim me masë sigurimi “arrest në burg”, në mungesë.
5. Operacioni i përbashkët në kuadër të **Procedimit Penal Nr. 301, i vitit 2021** dhe Skuadrës të Përbashkët Hetimore, me palë Suedi – SPAK - Ukrainë-Spanjë - 2 Gjermani Bamberg+ Dresden – Gjeorgji – Finlandë - Letoni. Në kuadër të këtij operacioni, janë regjistruar 5 persona nën hetim, nga të cilët 4 persona me masë sigurimi “arrest në burg”, dhe 1 person “arrest në shtëpi”.

Urdhërat për shpalljen në kërkim ndërkombëtar

Gjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë Shpallje në Kërkim Ndërkombëtar për 42 persona.

Ekstradimet

Gjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë **10** kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri, kryesisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet, 283/a, 297, 333/a, 334, 258 -25, 298/3, 28/5, 319 - 25, 232/a, 189,190, 79/dh, 278/1, 28/4, 109, 278/1, 152, 130/a/1, 139, 80, 245- 25, të Kodit Penal.

TABELA KRAHASUESE PËR VITET 2021-2022

LLOJI I KËRKESAVE	2021	2022
Kërkesa për Ndihmë Juridike nga Jashtë Vëndit	77	54
Kërkesat për Ndihmë Juridike për Jashtë Vëndit	51	62
Skuadrat e Përbashkëta Hetimore	5	10
Shpalljet në Kërkim Ndërkombëtar	15	42
Kërkesat për Ekstradim	17	10

Referuar tabelës krahasuese për vitin 2021 dhe 2022, rezulton se kemi një rritje në vitin 2022, për sa i përket Kërkesave për Ndihmë juridike për Jashtë Vëndit, Skuadrave të Përbashkëta Hetimor, si dhe Shpalljeve të shtetasve shqiptare apo të huaj në Kërkim Ndërkombëtar, kjo për shkak të rritjes së besimit nga/tek partnerët ndërkombëtare, si dhe efektivitetit të këtij bashkëpunimi.

Një rënie e lehtë vërehet tek Kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vëndit, kjo për arsye se është rritur numri i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, duke e vlerësuar këtë mënyrë bashkëpunimi më eficient dhe në kohe reale. Konkretisht vetëm në vitin 2022 janë krijuar 10 Skuadra të Përbashkëta Hetimore, dyfishi i Skuadrave të krijuara në vitin 2021. Ky bashkëpunim konsiderohet i suksesshëm pasi në kuadër të tyre në bashkëpunim partnerët ndërkombëtarë janë realizuar një sërë aksione /goditje, gjatë të cilave janë arrestuar një numër i konsiderueshëm personash duke iu caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”.

Projektet Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është asistuar në punën e saj nga programe të SH.B.A.-së, të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë kriminale të Shqipërisë dhe sektorin e zbatimit të ligjit — Programi Tejoqeanik i Ndihmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë (OPDAT) dhe Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), përfaqësues të së cilave janë të vendosur dhe fizikisht në ambientet e kësaj prokurorie.

Misioni OPDAT është përfshirë në rishikimin e legjislacionit të drejtësisë kriminale, trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve, hetuesve të BKH-së, në dhënien e pajisjeve të ndryshme teknike dhe

dhënien e ndihmës që synon rritjen e efektivitetit të SPAK. Ky misioni me anë të Këshilltarëve Ligjorë të Përhershëm, gjatë periudhës që nga krijimi e në vazhdim, ka ofruar asistencë për prokurorët për vendosjen e kontakteve me partnerë ndërkombëtarë, me synimin për ta ndihmuar në luftën e saj kundër krimit ndërkombëtar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Programi ICITAP, Përfaqësues të këtij programi, të cilët janë atashuar fizikisht pranë Prokurorisë së Posaçme kanë vazhduar këtë mbështetje gjatë gjithë vitit 2022, duke u përqendruar në : (a) Trajnimin për grupin e parë të hetuesve të BKH-së, i zhvilluar në SHBA; (b) përfundimin e procesit të përzgjedhjes dhe rekrutimit të grupit të dytë të hetuesve të BKH-së; dhe (d) caktimin e një ish Agjenti Special Mbikëqyrës, si këshillues dhe këshilltar për Drejtorin e BKH-së dhe hetuesit e BKH-së.

Një tjetër mision, i cili operon dhe jep ndihmesë, në punën e Prokurorisë së Posaçme është projekti i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të marrëveshjes **"IPA 2019/Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor"**, i përfaqësuar nga Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar, Mbretëria e Holandës. Projekti "Lufta kundër Krimit të Rëndë në Ballkanin Perëndimor", është vazhdimësi e projekteve të mëparshme, IPA 2010, IPA 2013 dhe IPA 2017. Ky projekt synon: forcimin e kapaciteteve operacionale të autoriteteve ligjzbatuese dhe atyre të sigurisë të Ballkanit Perëndimor, në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (Mbështetje Operacionale); mbështetjen e autoriteteve kombëtare përkatëse për të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe për të kontribuar në strukturat e BE-së dhe ato rajonale (Bashkëpunimi Strategjik); forcimin e kapaciteteve të autoriteteve ligjzbatuese dhe atyre të sigurisë të Ballkanit Perëndimor, në shkëmbimin e informacionit (Ndërveprimi i Sistemeve të Informacionit).

Mbështetja operacionale, konsiston në ndihmën për strukturat e SPAK për raste konkrete hetimore, Skuadra të Përbashkëta Hetimore (JIT) me vendet e tjera evropiane, nëpërmjet koordinimit, këshillimit dhe mbështetjes logjistike. Projekti ka organizuar dhe vazhdon të mbështesë disa takime operacionale, në Shqipëri dhe jashtë vendit, mes prokurorëve të SPAK-ut dhe homologëve të tyre nga vendet e rajonit si Kosova, Maqedonia e Veriut, etj., ashtu si dhe vendet dhe agjencitë e BE-së si: Italia, Holanda, Franca, Eurojust, OLAF, etj.

Bashkëpunimi strategjik - Projekti ka për synim forcimin e bashkëpunimit me agjencitë përkatëse të BE-së për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (p.sh. Europol, Eurojust) & rrjetet përkatëse evropiane (p.sh. Rrjeti Gjyqësor Evropian).

Projekti mbështet financiarisht Zyrën e Prokurorit Ndërlidhës shqiptar në Eurojust, duke mbështetur rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar midis SPAK dhe vendeve anëtare të BE- së në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe rritur besimin mes institucioneve shqiptare dhe atyre evropiane.

Ndërveprueshmëria e sistemeve të informacionit - Projekti mbështeti nënshkrimin e Marrëveshjes Trepalëshe për dhënien e të drejtës së qasjes në sistemin elektronik "SIENA - Aplikim i Sigurt i Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit", "EUROPOL", midis Prokurorisë së

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në kuadër të kësaj Marrëveshje trepalëshe, SPAK i shtohet listës së autoriteteve kompetente kombëtare që janë përgjegjës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat kanë qasje të drejtpërdrejtë në sistemin SIENA të Europol. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022, projekti mbështeti strukturat e SPAK, me pajisje, trajnime dhe ekspertizë të nevojshme për të krijuar qasjen e drejtpërdrejtë në kanalën e SIENA-s të Europol.

Projekti EU4FOCAL, i financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programi të asistencës IPA 2020, “Lufta kundër Krimit të Organizuar në Shqipëri nëpërmjet Hetimit Penal dhe atij Financiar”, ka realizuar disa trajnime të prokurorëve dhe hetuesve të SPAK-ut përsa i përket metodave të hetimit në fushën e pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale. Projekti gjithashtu është përfshirë në draftimin e një manuali në fushën e pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale, duke krijuar një grup me prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, SPAK dhe ekspertë të huaj, si dhe ka kryer një sërë aktivitetesh të tjera në mbështetje të këtij qëllimi.

EU4LEA është një projekt asistencë teknike i financuar nga BE me një mundësi për të ofruar pajisje, i projektuar për të mbështetur dhe ndihmuar agjencitë kryesore të zbatimit të ligjit shqiptar në veçanti Policinë e Shtetit Shqiptar, Ministrinë e Brendshme, SPAK (Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në), Prokurorinë e Përgjithshme, përfshirë ato të juridiksionit të përgjithshëm, në arritjen e objektivave të tyre dhe përafrimin e performancës së tyre me standardet më të mira të BE-së.

Janë parashikuar të realizohen lloje të ndryshme aktivitetesh, mbështetje këshillimore teknike dhe strategjike, vlerësime/analiza ligjore, përmbledhje e *acquis*-it përkatëse të BE-së, gamë e gjerë trajnimesh/seminarësh, ushtrime praktike simuluese në nivel qendror dhe vendor, vizita studimore në agjencitë e BE-së /vendeve anëtare të BE-së, rishikim/monitorim i rasteve penale, vizita në terren, etj.

Vizita studimore/trajnime/konferenca jashtë shtetit

Për vitin 2022, përveç takimeve koordinuese në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë marrë pjesë në **13** trajnime/vizita studimore, në **26** Takime/Konferenca/Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Gjithashtu është bërë një takim raportues në kuadër të Kapitullit 23, janë mbajtur 2 takime raportuese për Kapitullin 24, në kuadër të Moneyval janë bërë 2 takime si dhe 2 takime për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Prokuroria e Posaçme, në datën 8 Nëntor 2022, në kuadër të 30 vjetorit të krijimit të Drejtorisë Kombëtare Antimafia dhe Antiterrorizëm (DNA), si dhe në kuadër të bashkëpunimit në rritje

ndërmjet SPAK dhe DNA, ka zhvilluar një simpoziom në Shqipëri me tematikë “Krimi organizuar ndërkombëtar, sistemi i luftës kundër mafies dhe bashkëpunimi gjyqësor”.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë si penalistë/folës e Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Prokurori Kombëtar i DNA - Itali, Drejtuesi i Prokurorisë Romë, Drejtuesi i Prokurorisë Bari dhe një gjyqtar në Gjykatën e Lartë e Shqipërisë.

Pjesëmarrës të ftuar në simpoziom kanë qenë edhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, kandidatë për magjistratë në Shkollën e Magjistraturë, Drejtues të Prokurorive, anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe partnerë ndërkombëtarë të tjerë.

Marrëveshjet e bashkëpunimit, memorandum me agjencitë vendase dhe të huaja

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe vendeve fqinje dhe konkretisht:

- Në datën 04.02.2022, është nënshkruar Protokollin i Bashkëpunimit Ndërmjet Drejtorisë Kombëtare Antikorrupsion të Rumanisë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Shqipërisë;
- Në datën 14.11.2022, është nënshkruar, Memorandum i Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorisë për Hetimin të Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit të Rumanisë.

Grupe pune

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në Ligjin Nr. 95/2016, datë 06.10.2016, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në kushtet e ndryshimeve ligjore të bëra në Ligjin 10 193, datë 3.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, me Ligjin 100/2013 datë 18.03.2013, si dhe me Ligjin Nr. 97/2021 datë 07.07.2021, ka sugjeruar dhe ka marrë pjesë në ngritjen e dy grupeve të punës dhe konkretisht:

1. Ndryshimin e Udhëzimit të Përbashkët Nr. 3872/1 Prot, datë 3.6.2010 të Ministrisë së Brendshme dhe Nr. 02 Prot., datë 03.06.2010 të Prokurorisë së Përgjithshme “Për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, lidhur me përcaktimin e procedurave së nxjerrjes së urdhrin ndërkombëtar, si dhe rregullat e detajuara për afatet dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit për nxjerrjen dhe komunikimin e tij. Ky Udhëzim u nënshkrua më datë 24.06.2022.

2. Hartimin e Udhëzimit të Përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”. Ky Udhëzim është drejt finalizimit.

Problematika

Pranë Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, Specialistët Ndërlidhës trajtohen si nëpunës civil bazuar në Ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, (i ndryshuar).

Një situatë e tillë është në kundërshtim me funksionet që duhet të kryejnë Specialistët Ndërlidhës sipas Ligjit 95/2016, pasi kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale dërguar nga/për autoritetet e huaja, si dhe hetimet e përbashkëta, bazohen në Konventa shumëpalëshe, dypalëshe, Kodin e Procedurës Penale, si dhe Ligjin 10.193 datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetete e Huaja në Çështjet Penale”, (i ndryshuar), të cilat kanë si objekt kryerjen e veprimeve procedurale.

Në situatën aktuale ku Specialistët Ndërlidhës kanë statusin e “nëpunësit civil”, ata nuk mund të kryejnë veprimet procedurale. Këto veprime deri më tani jemi detyruar t’i kryejmë kryesisht me Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndërkohë që Specialistët Ndërlidhës, kanë kryer veprime administrative dhe ndihmëse.

Duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë juridike, dhe skuadrat përbashkëta hetimore, janë në rritje, referuar statistikave vjetore, është e domosdoshme që këto veprime të kryhen nga ndërlidhësit e këtij sektori duke iu dhënë atyre atributet e Oficerit të Policisë Gjyqësore, duke saktësuar statusin ashtu dhe pagën e tyre.

Të njëjtin status, oficerë të policisë gjyqësore, kanë dhe specialistët përkatës në Prokurorinë Përgjithshme.

Prokuroria e Posaçme nëpërmjet shkresës Nr. 10 452 Prot., datë 30.11.2022, i është drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, duke i propozuar disa ndryshime dhe shtesa mbi domosdoshmërinë për disa përmirësime ligjore të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, konkretisht ndryshimin e pikën 3, 4 dhe shtimin e pikës 5 të nenit 22, ndryshimin e paragrafit të germës “b”, në pikën 1 të nenit 23.

Përsa më sipër kërkohet mbështetja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore.

10. Aktiviteti i Koordinatorit për Mediat në SPAK

Përgjatë vitit 2022, Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat, mbështetur në kuadrin ligjor dhe udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ka informuar publikun për punën e Prokurorisë së Posaçme nëpërmjet komunikimit me gazetarë respektivë nga të gjitha mediat si edhe gazetarë të pavarur në Republikën e Shqipërisë, në rajon dhe më gjerë.

Në funksion të arkivimit të kërkesave për informacion hyrës dhe dalës në Prokurorinë e Posaçme, aktivizimi i Koordinatorit për Marrëdhënien me Mediat ka mundësuar mbajtjen në mënyrë të vazhdueshme dhe të përditësuar të *'Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve'*, i cili sipas ligjit në fuqi (Ligji nr. 119/2014 – Për të drejtën e informimit) duhet të publikohet dhe përditësohet njëkohësisht në faqen zyrtare të institucionit çdo 3 muaj. Kjo procedurë monitorohet sistematikisht nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sikurse është vepruar edhe për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2022 për SPAK.

Nënvizohet se *'Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve'* i përditësuar publikohet në faqen zyrtare të SPAK, në menun *'Programi i Transparencës'*.

Duhet theksuar se, në “kërkesa zyrtare për informacion”, të shënuara në *Regjistrin e Koordinatorit*, nuk janë konsideruar pyetjet e ndryshme për komente që vijnë kryesisht nga gazetarët, të cilat janë më të shpeshta dhe më të shumta në numër se sa kërkesat zyrtare dhe lidhen me specifika të çështjeve dhe hetimeve të ndryshme nën kompetencën e Prokurorisë së Posaçme.

Në kërkesat për informacion, në funksion të përditësimit të *'Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve'* **nuk janë konsideruar** intervistat, me shkrim a me incizim para kamerës, qoftë me gazetarë nga Republika e Shqipërisë qoftë me gazetarë nga rajoni dhe më gjerë apo të niveleve Evropiane. Gjithsesi, në funksion të informimit sa më të plotë të publikut, janë dhënë një numër intervistash, të filmuara apo jo, nga Drejtuesi i SPAK si edhe Zv/Drejtuesi, për llogari të gazetarëve ndërkombëtarë, p.sh. Deutsche Welle, Bruksel, Al Jazeera etj.

Ndaj të gjithave kërkesave zyrtare për informacion, ardhur nga gazetarë por edhe nga subjekte të ndryshme, është dhënë përgjigje e plotë dhe, për secilin rast, **brenda afatit të përcaktuar ligjor**.

Informacioni që i kërkohet Prokurorisë së Posaçme, qoftë nëpërmjet kërkesave me shkrim / postës elektronike të institucionit, qoftë në rrugë telefonike nëpërmjet Koordinatorit për Marrëdhënien me Mediat, apo nga kërkesa specifike për të marrë intervistë, me incizim apo me shkrim direkt nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i ka qenë i lartë dhe vetëm në rritje të vazhdueshme përgjatë vitit 2022.

Kërkesat për informacion janë të natyrave të ndryshme duke filluar që nga specifikat e hetimeve për çështje të ndryshme deri tek pushimet dhe mosfillimet e çështjeve hetimore.

Ndër çështjet që është kërkuar më tepër informacion rezultojnë çështjet e lidhura me korrupsionin si p.sh. hetime për zyrtarë të nivelit të lartë, kërkesa informacioni për sekuestrime të ndryshme, krimet zgjedhore, inceneratorët, çështja Gërdeci, procedurat e tenderimeve të ndryshme, afëra të institucioneve publike dhe shoqërive të ndryshme tregtare etj.

Kërkesat lidhur me të drejtën e informimit i sjellin më së shumti subjektet për kallëzimet që kanë paraqitur, gazetarë vendas dhe të huaj si edhe nga redaksi, platforma dhe OJF të ndryshme.

Përgjatë vitit 2022 ka rezultuar të ketë konkretisht:

➤ **162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) kërkesa zyrtare për informacion**

Të shpërndara në muaj si vijon:

- 8 kërkesa për informacion gjatë muajit Janar;
- 6 kërkesa për informacion gjatë muajit Shkurt;
- 7 kërkesa për informacion gjatë muajit Mars;
- 8 kërkesa për informacion gjatë muajit Prill;
- 16 kërkesa për informacion gjatë muajit Maj;
- 25 kërkesa për informacion gjatë muajit Qershor;
- 22 kërkesa për informacion gjatë muajit Korrik;
- 3 kërkesa për informacion gjatë muajit Gusht;
- 13 kërkesa për informacion gjatë muajit Shtator.
- 20 kërkesa për informacion gjatë muajit Tetor.
- 7 kërkesa për informacion gjatë muajit Nëntor.
- 27 kërkesa për informacion gjatë muajit Dhjetor.

Gjatë vitit 2022, duke ndjekur udhëzimet e dala nga Zyra e Komisionerit, SPAK publikoi në faqen zyrtare të institucionit ‘*Programin e Transparencës*’. Ky program transparence vjen në respektim të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; urdhrit Nr. 187, datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Si risi e lidhur me respektimin e së drejtës për informim, ‘Programi i Transparencës’ ka pasqyruar gjithë informacionin e plotë lidhur me të drejtën për t’u informuar dhe për t’u ankuar, për të marrë informacion dhe kontakt të drejtpërdrejtë me Koordinatorin për Marrëdhënien me Mediat në SPAK i cili, është i vetmi person i autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për të komunikuar me mediat në emër të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me hetime apo çështje penale, në respekt të Nenit 24, Ligji nr.95/2016, si dhe çdo informacion, kuadër ligjor, dokumentacion a shërbim që është gjykuar se mund të bëhet publik lidhur me autoritetin. Së bashku me *Programin e Transparencës* gjenden gjithashtu dhe ‘Modelet’ e kërkesës dhe ankesës, i formateve për kërkim të informacionit/ dokumentacionit” që rekomandohet të përdoret për t’u drejtuar zyrtarisht SPAK.

Gjatë muajit prill e në vijim, Prokuroria e Posaçme ka publikuar në faqen zyrtare Përmbledhjen Mujore me tregues të punës dhe statistikat mujore të Strukturës së Posaçme. Përmbledhja e muajit që kalon publikohet në ueb çdo fillim muaji të ri me titull si për shembull: *“Tregues të punës në SPAK - dhjetor 2022”* për të gjithë aktorët dhe palët e interesuara.

Gjatë 2022, SPAK ka zhvilluar një sërë konferencash për shtyp në lidhje me forcimin e bashkëpunimeve të SPAK me autoritete gjyqësore të huaja dhe institucione ndërkombëtare lidhur me hetime komplekse në kuadrin e ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore.

Gjatë këtij viti është punuar gjithashtu për përmirësimin dhe konfigurimin e ri të faqes zyrtare web të SPAK, që është ende në proces. Është rritur më tej edhe komunikimi me publikun nëpërmjet llogarisë “teitter” në rrjetet sociale e cila është aktivizuar që prej muajit nëntor 2021.

11. Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 202

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, i cili krijohet sipas pikës 12 të nenit 57, dhe e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të ligjit. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” ka në përbërje të tij dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, (nga tre anëtarë në tërësi) të zgjedhur me short, ku procesi i përzgjedhjes monitorohet nga Avokati i Popullit.

Gjatë vitit 2022 Komisioni ka përfunduar verifikimet e plota të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 74 (shtatëdhjetë e katër) kandidatë për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Po gjatë këtij viti Komisioni ka filluar dhe ka vazhduar procesin e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës edhe për 84 (tetëdhjetë e katër) punonjës të administratës së Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe për 2 (dy) kancelarë të Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit. Gjatë vitit 2022 Komisioni ka filluar verifikimet e Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 13 kandidatë për hetues të Seksionet Financiar në Prokurorinë e Posaçme.

Ky Komision kryen një punë shumë voluminoze, pasi përveç vendimmarrjes për kryerjen e verifikimeve nga ILDKPI dhe DSIK, vazhdon me analizën e thelluar të raporteve të përcjella nga këto dy institucione, për çdo subjekt verifikimi. Kryen verifikime të drejtpërdrejta në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme, Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, SHISH, Shërbimin Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentin e Administratës Publike.

Në rastin e kandidatëve për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, administron dhe analizon rezultatet e testit të poligrafit për çdo subjekt.

Pas administrimit dhe analizimit të të gjitha të dhënave të grumbulluara Komisioni përpilon dhe i përcjell institucionit të emërtesës raportin e hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës.

Në përmbledhje të vitit 2022, Komisioni ka përfunduar raportet e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për **74 (shtatëdhjetë e katër)** subjekte dhe kryen dhe vazhdon verifikimet edhe për **99 (nëntëdhjetë e nëntë)** subjekte.

12. Aktiviteti i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka si qëllim menaxhimin, zhvillimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe ofrimin e mbështetjes për sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të institucionit, me qëllim krijimin e një ambienti pune sa më efikas të sigurt, (*user-friendly*) dhe që ju vjen në ndihmë prokurorëve, hetuesve të BKH-së dhe stafit të administratës për kryerjen e punëve të përditshme. Është punuar në disa drejtime, ku sistemet janë ndarë sipas kategorive dhe investimeve dhe është sqaruar i detajuar roli dhe puna e kryer nga DTI për çdo kategori gjatë vitit 2022 si më poshtë:

- a) Konfigurimi i infrastrukturës fizike dhe logjike të pajisjeve Qendrore të Data Center
- b) Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtare
- c) Qëllimi dhe puna e kryer deri tani
- d) Problematikat

Konfigurimi i infrastrukturës fizike dhe logjike të pajisjeve Qendrore të Data Center.

Është ndërtuar një Infrastrukturë Informatike moderne sipas parametrave teknike bashkëkohorë, si dhe sisteme kontrolli dhe sigurie për të garantuar sigurinë maksimale të institucionit e cila është rikonfiguruar gjatë vitit që kaloi për tu përshtatur dhe përmirësuar në baze të kërkesave të shtuara për siguri.

Janë vënë në funksion të plotë të gjitha pajisjet qendrore duke krijuar një infrastrukturë fizike dhe logjike plotësisht funksionale me disponueshmëri me shume se 99.99%.

Kjo infrastrukturë është ngritur në Datacenter-in qendror të institucionit, sipas kërkesave dhe parametrave teknike si temperatura lagështia e ajrit për të garantuar funksionim normal të sistemeve dhe garantuar punën e pajisjeve sipas parametrave optimale teknike.

Deri tani është ngritur një infrastrukturë hardëare moderne brenda godinës, e cila ju shërben punonjësve për realizimin e punës të përditshme, është ngritur një sistem “Domain Controller” dhe sistemi i postës elektronike zyrtare.

Sistem TIK i “SPAK” është llogaritur që të përballojë një trafik të dhënash shumë të lartë, pasi sipas te SPAK duhet të ketë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave shtetërore për të aksesuar në kohë reale informacionin e kërkuar për të shkurtuar kohën e aksesimit të të dhënave, ulur kostot nga komunikimi shkresor dhe ruan sekretin hetimor, pasi nuk ka nevojë të kërkoet informacioni nga palë të treta.

Ne kuadër të këtyre zhvillimeve, janë kryer lidhjet fizike dhe realizohet mirëmbajtja e tyre dhe konfigurimet si më poshtë:

- Lidhje direkte me Fiber Optike (FO) me Policinë e Shtetit, ku është marrë akses në sistemin TIMS dhe sistemet e tjera që ofron ky institucion si E-gjoha, Raporte-Statistika, Adam, apo sisteme ndërkombëtare si Interpol, Europol për të mundësuar bashkëpunim në kohe reale me partneret ndërkombëtarë.
- Lidhje me FO me Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë në rastet e transferimit të dosjeve apo komunikimin elektronik të sistemeve.
- Lidhje me FO me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nëpërmjet të cilës mundësohet akses në bazat e të dhënave shtetërore, pasi pjesa më e madhe e institucioneve janë në GovNet.

Për sa i përket sigurisë dhe monitorimit të godinës janë përforcuar sistemet e aksesit dhe mirëmbajtja e tyre si më poshtë:

- Sistem i monitorimit të kamerave CCTV, janë shtuar numri i kamerave për të siguruar një mbulim më të plotë të çdo ambienti brenda dhe jashtë godinës së SPAK.
- Sistemi i Aksesit, ky sistem lejon aksesin e punonjësve në ambientet e zyrave të SPAK nëpërmjet kartës së aksesit, ku çdo punonjës është i pajisur me kartën e tij personale me numër unik identifikimi për një menaxhim sa më efikas për akses të kufizuar sipas zonave të sigurisë në varësi të detyrave funksionale.
- Sistemi Biometrik i aksesit, ky sistem lejon aksesin e punonjësve në ambientet e zyrave të SPAK nëpërmjet të dhënave biometrike, Ky sistem është vendosur në zonat e sigurisë së lartë, ku përdoren sisteme biometrike me disa nivele të teknologjisë më të fundit.
- Sistemi anti-zjarr dhe rrjeti me sensorë për detektimin e lëvizjeve për sigurinë e zyrave pas përfundimit të punës.
- Skanerat me rreze infra për skanimin e çantave për përmbajtje metalike, kimike apo biologjike në hyrje të godinës.
- Sistemi Perimetral i përbërë nga sensorë dhe barriera me rreze infra për detektimin e shkeljes së perimetrit të institucionit duke sinjalizuar në kohe reale personat përgjegjës për sigurinë e godinës.
- Gjate vitit 2022 këto sisteme janë mirëmbajtur dhe përmirësuar për t kryer funksionin e tyre.

Financimet nga partnerët ndërkombëtarë

Një ndihmë e madhe në fushën e IT është ofruar nga partnerët ndërkombëtarë si misionet ICITAP dhe OPDAT.

Mund të përmendim ndihmën në pajisje fizike dhe infrastrukturë, ku rolin kryesor e ka ICITAP, mision i cili gjatë vitit 2022 ka ofruar ndihmë në pajisje dhe asistencë teknike për konfigurimet e pajisjeve të dhuruara.

Ndryshimet në konfigurime apo pajisjet dhe softërat të cilat janë shtuar gjatë vitit 2022 janë marrë në dorëzim nga DTI dhe është kryer dokumentimi i plotë dhe integrimi në sistemet aktuale për tu shfrytëzuar maksimalisht potenciali i tyre fizik apo logjik përpunues.

13. Plotësimi me personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022 ka shpallur procedura për plotësimin e vendeve vakante në faqen zyrtare të SPAK-ut, në mbështetje të Ligjit 95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve Për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”; Ligjit Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM-së Nr. 242 dhe 243 datë 18.03.2015 i ndryshuar “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022 kanë ushtruar detyrën **160 punonjës**.

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në përbërje të saj për vitin 2022 kishte **90 punonjës, nga të cilët 17 Prokurore, 68 punonjës administrativë dhe 5 punonjës me kontratë**.
2. Byroja Kombëtare e Hetimit në përbërje të saj për vitin 2022 kishte **70 punonjës, nga të cilët 61 Hetues, 6 punonjës administrativë dhe 3 punonjës me kontratë**.
3. Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2022, janë kryer procedura të reja punësimi ku janë shtuar **18 punonjës** nga të cilët:
 - të emëruar me kontratë pune janë **7 punonjës** (1 (një) ekspert dhe 6 (gjashtë) punonjës mbështetës (magaznier, mirëmbajtës, shoferë)
 - të emëruar me procedura sipas Ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, janë **11 punonjës**, nga të cilët (4 punonjës të emëruar me procedurën “*pranim në shërbimin civil*”, 5 punonjës të emëruar me procedurën “*lëvizje paralele*” dhe 2 punonjës të emëruar me procedurën “*ngritje në detyrë*”)

- në mbështetje të VKM-së Nr. 35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme” si dhe VKM-së Nr. 537, datë 29.07.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 35”, pranë Prokurorisë së Posaçme për vitin 2022 kanë ushtruar funksionin **6 punonjës** me kontratë pune me afat 6 mujor.

Aktualisht janë në proces vetingu edhe **8 kandidatët** të cilët kanë aplikuar në pozicionin Hetues Financiar, sipas procedurave të shpallura në faqen zyrtare të SPAK.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar referuar akteve ligjore në fuqi ka proceduar duke pajisur me Certifikatë Sigurie në tërësi stafin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Gjatë vitit 2022 punonjësit administrativ të emëruar sipas procedurave sipas Ligjit “Për statusin e nëpunësit civil kanë ndjekur trajnimin e detyrueshëm të ASPA. Kanë dhënë dorëheqjen për arsye personale 2 punonjës nga statusi i shërbimit civil.

14. Analizë e të dhënave buxhetore të SPAK për vitin 2022

Me qëllim kontribimin në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit buxheti i SPAK-ut, mbështetet plotësisht në Ligjet dhe udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës. Menaxhimi Financiar është fokusuar në financimin e shpenzimeve për përmbushjen e objektivave parësor strategjik të institucionit si:

- Krijimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme për Prokurorët, Hetuesit e BKH dhe personelin administrativ, në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.
- Përdorimin e teknologjisë më të avancuar në funksion të ekspertizës dhe hetimeve proaktive sipas kompetencës ligjore të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- Paraqitjen e një produkti hetimor cilësor, që përkthehet në raste të suksesshme të përfunduara dhe të dërguara për gjykim pranë GJKOK.
- Përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të punës në shërbim të një trajtimi sa më efektiv të rasteve hetimore.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale si dhe të krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit.
- Mirë administrimin e institucionit, duke aplikuar metodologjitë më të përparuara si në menaxhimin financiar ashtu edhe në trajtimin e burimeve njerëzore.

Në këtë seksion të raportit evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e zbatimit të

buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në zbatim të Ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” buxheti i SPAK është planifikuar në vlerën 1,038 milion lekë, dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 663.3 milion lekë, fonde të cilat SPAK i ka administruar për financimin e aktiviteteve në një program me emertimin “Veprimtaria e SPAK”.

Buxheti Vjetor 2022

Titulli	Emertimi	1 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	2 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	3 Fakti Vjetor 2022	4=(2-3) Diferenca	% e realizimit plan fakt
03390	Veprimtaria e SPAK	1,038,800	663,300	588,063	75,237	89%
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		1,038,800	663,300	588,063	75,237	89%

Realizimi në total i shpenzimeve është rreth 588 milion lekë ose rreth 89% të buxhetit vjetor të rishikuar.

Me miratimin e detajimit të fondeve buxhetore të shpërndara për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH-në, gjatë vitit 2022 është vijuar me marrjen e angazhimeve dhe kryerjen e pagesave bazuar në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, brenda limiteve dhe në afatet e përcaktuara,

Raporti i shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike

Art.	Emertimi	1 PBA Plan Viti 2022	2 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	3 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	4 Buxheti 2022	5 Fakti 12- mujor	6=(5-4) Diferenca	Realiz ne %
600	Paga	697,109.0	697,109.0	474,081.0	474,081.0	429,825.6	-44,255.4	73%
601	Sigurime Shoqërore	183,574.0	183,574.0	44,985.0	44,985.0	38,006.2	-6,978.8	6%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	128,117.0	128,117.0	121,305.0	121,305.0	99,042.2	-22,262.8	17%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		329.0	1,928.9	1,928.9	1,838.9	-90.0	0%
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	1,008,800.0	1,009,129.0	642,299.9	642,299.9	568,712.9	-73,587.0	97%
231	Kapitale të Trupëzuara	30,000.0	30,000.0	21,000.0	21,000.0	19,350.4	-1,649.6	3%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	30,000.0	30,000.0	21,000.0	21,000.0	19,350.4	-1,649.6	3%
Totali	Shpenzime Kapitale	30,000.0	30,000.0	21,000.0	21,000.0	19,350.4	-1,649.6	3%
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				0.0		0.0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		1,038,800.0	1,039,129.0	663,299.9	663,299.9	588,063.3	-75,236.6	100%

Shpërndarja e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës dhe kërkesat e SPAK për të përmbushur detyrimet ligjore.


Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të instiucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041002,

Në vitin 2022, është vijuar puna intensivisht në konsolidimin e SPAK-ut në drejtim të ngritjes së strukturave duke synuar në konsolidimin financiar dhe administrativ të institucionit me qëllim arritjen plotësisht të realizimit buxhetor dhe treguesve të performancës të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Nëse i referohemi peshës specifike të llogarive ekonomike të shpenzimeve të planifikuara për zërat shpenzime për paga, për sigurime shoqërore shpenzime për mallra dhe shërbime si dhe ato për investime mbi totalin e shpenzimeve buxhetore të sipas planit të rishikuar pesha specifike grafikisht paraqitet:


Pesha sipas llogarive ekonomike e planit të buxhetit viti 2022



Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të SPAK-ut, ashtu siç mund të konstatohet në grafikun më lart, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zënë llogaria “Paga” në rreth 71%, pasuar nga llogaria “Mallra dhe shërbime të tjera” me rreth 18%, ndërkohë që “Sigurime” zënë rreth 7% dhe “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë 3%.

Grafikisht pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve faktike të buxhetit 2022 mbi totalin e realizimit, paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:

Pesha e realizimit faktik sipas llogarive ekonomike



Përsa i përket realizimit faktik, rezulton se në peshën e llogarive ekonomike ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara, evidentohet një ruajtje të peshës së këtyre shpenzimeve si në buxhetin e planifikuar ashtu edhe në atë të realizuar për vitin 2022. Qëndrueshmëria financiare e

institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të institucionit.

Nëse do të vendosim në analizë treguesit e realizuar për vitin 2022 krahasuar me realizimin për vitin 2021, të cilët paraqiten sipas tabelës së poshtë shënuar:

Raporti i shpenzimeve te programit për vitin 2021 dhe 2022

Llog. Ekonomike	Emertimi	2021 Fakti 12-mujor	2022 Fakti 12-mujor	Diferenca (viti 2022-2021)
600	Paga	237,038.00	429,825.6	192,788
601	Sigurime Shoqërore	22,215.00	38,006.2	15,791
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	40,056.00	99,042.2	58,986
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	219	1,838.9	1,620
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	299,528.00	568,712.90	269,185
230	Kapitale të Patrupëzuara			-
231	Kapitale të Trupëzuara	26,230.00	19,350.4	- 6,880
Totali	Shpenzime Kapitale	26,230.00	19,350.4	- 6,880
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				-
Totali (korrente + kapitale)		325,758.00	588,063.30	262,305

